

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE

2026

Nr. Rendor ¹	Data e kërkesës ²	Objekti i kërkesës ³	Data e përgjigjes ⁴	Përgjigje ⁵	Mënyra e përfundimit të kërkesës ⁶	Tarifa ⁷
1.	31.12.2025	Përsëhendetje, Që me komunikimin e datës, 16.04.2025 ora 1:07 PM të IKMT-së ku më është komunikuar se nuk mund të më mundësohet kopje e shkresës me nr. 38/4 prot. datë, 27.02.2025 të DRIKMT Lezhë si dhe kopje të procesverbalit nr. 02 datë, 26.02.2025 “Për konstatimin e kundërvajtjes” për arsyen se procedura në fjalë është ende në shqyrtim ndaj nuk mund të bëhen publikime deri në përfundimin e procesit, shprehem se IKMT me kthimin e përgjigjes së datës, 09.12.2025 të ankesës time me numër gjurmimi MB-2025-6245217-BI më ka komunikuar qëndrimin e mbajtur me shkresën nr. 20211 prot. datë, 25.11.2025 të IVMT pranë Bashkisë Lezhë	07.01.2026	Përsëhendetje, Në vijim të kërkesës suaj për informacion ju bëjmë me dije se referuar ligjit Nr. 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit” dhe të ligjit Nr. 9887/2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar, informacioni i kërkuar nga ana juaj nuk mund t’ju vihet në dispozicion pasi aktet përmbajnë të dhëna të cilat i përkasin një subjekti tjetër. Faleminderit,		

		dhe në vlerësimin tim nuk ka më argumenta nga IKMT për trajtimin e ankesës time dhe në këto kushte proçesi ka të dhëna që është përfunduar. Per sa me siper ne zbatim dhe te ligjit nr. 119/2014 “Per te drejten e informimit” kerkoj te dhena te regjistruara ne çfaredo lloj forme dhe formati, gjate ushtrimit te funksionit publik nga institucioni i Inspektoriatit Kombetare te Mbrojtjes se Territorit ne lidhje me, te me veje ne dispozicion nje kopje te shkreses me nr. 38/4 prot. date, 27.02.2025 te Drejtorise Rajonale te IKMT Lezhe dhe te procesverbalit nr. 02 date, 26.02.2025 me nr. serie 00001802 “Per konstatimin e kundravajtjes”. Duke ju falenderuar, mbetem ne pritje te nje pergjigjeje nga ana e institucionit tua				
2.	09.01.2026	Përshëndetje, Në vijim të informacionit të shkëmbyet më sipër, rezulton se arkëtimet nga gjobat për të njëjtat	16.01.2026	E nderuar, Referuar pyetjes lidhur me diferencën e numrit të gjobave ndërmjet periudhave janar–maj 2024 dhe janar–maj 2025, sqarojmë	E plote	Nuk ka

		periudha (janar-maj) në vitin 2025 janë ulur me 74 %. Konkretisht, sipas të dhënave që 3ecto keni vënë në dispozicion, rezulton se vlera e gjobave ka lëvizur, nga 896 mln → në 226 mln ↘ -74% Për sa më sipër, ju drejtojmë pyetjen: 4. Si e shpjgoni këtë rënie, a ka ndonjë element 3ectorial që e justifikon? Të dhënat e grumbulluara dhe përgjigjja juaj do të përdoret në kuadër të një artikulli investigues. Faleminderit		se ndryshimi varet kryesisht nga intensiteti dhe shtrirja e inspektimeve në terren, numri i rasteve të konstatuara në shkelje të ligjit, kërkesat e qytetarëve, si dhe kërkesat për ndërhyrje dhe bashkëpunim nga institucione të tjera. E rëndësishme të theksohet se Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit (IKMT) ka kompetencë për kontrollin, parandalimin dhe goditjen e ndërtimeve të kundërligjshme në zonat me rëndësi kombëtare. Ky kontroll përfshin zonat prioritare për zhvillimin e turizmit, monumentet dhe qendrat historike, zonat e mbrojtura natyrore dhe arkeologjike, vijën bregdetare, burimet ujore kryesore, si dhe infrastrukturën dhe objektet strategjike të rëndësisë kombëtare. Për shkak të karakterit të paparashikueshëm të konstatimeve të ndërtimeve të kundërligjshme dhe të fushave të ndryshme të punës së IKMT-së, përfshirë ndërtimin, mjedisin dhe pyjet, si dhe për shkak të shtrirjes	
--	--	---	--	--	--

				kombëtare të kompetencave, intensiteti dhe shtrirja e inspektimeve ndryshon nga një vit në tjetrin, duke ndikuar drejtpërdrejt në numrin e gjobave. Gjithashtu, gjatë periudhës janar–maj 2024, IKMT ka qenë e përfshirë në disa projekte me interes publik dhe ka zbatuar Urdhërin e Ministrit të Brendshëm Nr. 44, datë 16.02.2024, për ndalimin dhe mbylljen e vendgrumbullimeve të mjeteve motorike dhe pjesëve të tyre të dala jashtë përdorimit pranë akseve kombëtare. Këto aktivitete kanë çuar në një rritje të ndjeshme të numrit të inspektimeve dhe procedurave të kryera gjatë asaj periudhe, gjë që shpjegon pjesërisht ndryshimin e numrit të gjobave krahasuar me periudhën e mëvonshme. Duke ju falënderuar për mirëkuptimin,		
3.	12.01.2026	Pershendetje, Kerkojme informacion ne lidhje me vendimin bashkelidhur	23.01.2026	Përschendetje, Në përgjigje të kërkesës suaj dhe në vijim të inspektimit të kryer më	E plote	Nuk ka

		<i>“Lënien në fuqi të vendimit përfundimtar dhe rrëzimin e ankimit për vendimin përfundimtar” të marrë nga Komisioni I shqyrtimit të ankimimeve, INSPEKTORATI KOMBËTAR I MBROJTJES SË TERRITORIT për bashkinë Krujë 5en j poshtë:</i> A është zbatuar ky vendim? A është paguar nga ana e bashkisë Krujë gjopa e venë sipas këtij vendimi? Nëse po, kur është paguar dhe cila është shuma? Në pritje 5en je përgjigjeje sa më të shpejta nga ana juaj,		datë 25.05.2025 në zonën Kodër-Dollak, Fushë Krujë, Bashkia Krujë, Qarku Durrës, ju bëjmë me dije sa vijon: Bazuar në nenin 30 të Ligjit nr. 10279, datë 20.02.2009, “Për kundërvajtjet administrative”, citohet se: “Gjopa dhe shumat që duhet të paguhen sipas vendimit për kundërvajtjen administrative, të nxjerrë në përputhje me dispozitat e këtij ligji, paguhen nga kundërvajtësi brenda 10 ditëve nga data kur është njoftuar për vendimin e dënimit me gjobë, i cili përbën titull ekzekutiv. Pas kalimit të këtij afati, për çdo ditë vonesë paguhet kamatëvonesë prej 2% në muaj të masës së gjobës, përveç rasteve kur ligji i posaçëm parashikon përqindje të ndryshme.” Subjekti, Bashkia Krujë, ka marrë dijeni për vendimin e Komisionit të Shqyrtimit të Ankimeve Administrative më datë 30.07.2025 dhe kishte një afat prej	
--	--	---	--	---	--

				10 ditësh për kryerjen e pagesës së gjobës. Pas përfundimit të afatit ligjor dhe për shkak të moskryerjes së pagesës në mënyrë vullnetare, IKMT ka dërguar kërkesën për lëshimin e urdhrit të ekzekutimit më datë 06.10.2025 pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së parë Tiranë. Më pas, më datë 19.11.2025, jemi njoftuar nga gjykata se kërkesa për lëshimin e urdhrit është pranuar pjesërisht, pra është pranuar lëshimi i urdhrit për gjobën dhe është refuzuar lëshimi i urdhrit për kamatëvonesën. Ndaj pjesës së vendimit që ka të bëjë me kamatëvonesën, nga ana jonë është ushtruar ankim po në datën 19.11.2025. Aktualisht, jemi në pritje të njoftimit zyrtar të vendimit për lëshimin e urdhrit të ekzekutimit dhe dërgimit të kopjes origjinale të tij nga gjykata, në mënyrë që më pas të procedojmë me ekzekutimin e gjobës nëpërmjet shërbimit	
--	--	--	--	---	--

				përmbardimor, siç përcaktohet nga Kodi i Procedurës Civile. Ju falënderojmë për mirëkuptimin.		
04.	12.01.2026	Pëshëndetje, Në bazë të ligjit .nr.119 dt. 18.09.2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar, neni 3, jeni të lutur të gjeni mëposhtë pyetjet tona të kësaj kërkesë për informacion. Po ju dërgoj disa pyetje në këtë kërkesë për informacion: 1.Sa është numri i rasteve të identifikuar nga ana juaj gjatë periudhës 2015-2025, ku si rezultat i veprimtarisë së bizneseve të mëdha janë shkelur rregulloret dhe ligjet për mbrojtjen e mjedisit? Ju lutem, specifikoni rastet sipas zonave (rurale dhe urbane) dhe llojit të ndotjes së shkaktuar. 2.Cilat janë masat administrative apo ndëshkimore të ndërmarra ndaj këtyre bizneseve? Ju lutem,	03.02.2026	Pëshëndetje, Në përgjigje të kërkesës suaj për informacion, lidhur me rastet e identifikuar nga Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit (IKMT), përmes Drejtorisë së Inspektimeve në Mjedis dhe Ujëra, ju informojmë se: Drejtoria e Inspektimit të Mjedisit dhe Ujërave është ngritur dhe ka filluar funksionimin si pjesë e strukturës së Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit (IKMT) në periudhën nëntor të vitit 2020. Për rrjedhojë, IKMT nuk disponon të dhëna lidhur me subjektet e gjobitura apo masat administrative të marra për ndotje të shkaktuara para këtij viti. Sa i përket numrit të subjekteve që, përmes veprimtarisë së tyre, kanë rezultuar në shkelje të legjislacionit	E plote	Nuk ka

		na specifikoni masat e sakta për secilën ngjarje/rast të identifikuar.		në fuqi për mbrojtjen e mjedisit, ju informojmë se numri mesatar vjetor i rasteve varion nga 100 deri në 150 raste në vit. Nga këto raste, rreth 55%–65% kanë ndodhur në zona industriale, ndërsa pjesa tjetër në zona rurale dhe urbane. Sa i përket natyrës së shkeljeve të konstatuara, në rreth 60% të rasteve ndotja është shkaktuar nga keqmenaxhimi i mbetjeve të parrezikshme dhe të rrezikshme, në rreth 20% të rasteve nga ndotja e ajrit, në rreth 25% të rasteve nga shkarkime të ujërave të ndotura urbane dhe industriale të patrajtuara në mjedisin pritës ujqor dhe/ose tokësor, ndërsa në rreth 5% të rasteve është konstatuar ndotje akustike, fenomen ky më i theksuar në zonat urbane të banuara. Masat administrative janë vendosur në përputhje me natyrën e shkeljeve të konstatuara dhe në zbatim të legjislacionit në fuqi. Për shkeljet në fushën e menaxhimit të mbetjeve është aplikuar ligji nr. 10463 “Për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve”, i cili parashikon masa		
--	--	--	--	---	--	--

				administrative në vlerën nga 1.500.000 lekë deri në 2.000.000 lekë, të shoqëruara, në shumicën e rasteve, me pezullim të pjesshëm ose të përkohshëm të aktivitetit që ka kryer kundërvajtjen, si dhe me referimin e rasteve pranë Policisë së Shtetit për kallëzim penal. Për shkeljet që lidhen me shkarkimet e pakontrolluara të ujërave, si dhe me përdorimin e burimeve ujore nëntokësore apo sipërfaqësore pa lejen përkatëse administrative, janë zbatuar masat administrative të parashikuara në ligjin nr. 29/2024 “Për Burimet Ujore”, të cilat variojnë nga 500.000 lekë deri në 2.000.000 lekë, të shoqëruara me pezullim të pjesshëm ose të përkohshëm të aktiviteteve, ndërsa në rastet e shfrytëzimit të lumenjve, të gjitha rastet janë referuar pranë Policisë së Shtetit për kallëzim penal. Për ndotjen e ajrit, në zbatim të ligjit nr. 162/2014 “Për Mbrojtjen e Cilësisë së Ajrit”, janë marrë masa administrative që variojnë nga 1.000.000 lekë të reja deri në 2.000.000 lekë të reja, si dhe		
--	--	--	--	--	--	--

				pezullim i pjesshëm ose i përkohshëm i burimit ndotës, qoftë aktivitet, makineri dhe/ose pajisje, ndërkohë që është kërkuar vlerësim nga ekspertë dhe institucione të tjera kompetente për të përcaktuar ekzistencën e ndotjes së lartë, me qëllim referimin e çështjes pranë organit të prokurorisë. Faleminderit.		
05	15.01.2026	Pëshëndetje, Kam bere ankesen ne lidhje me prerjen e pyllit, te dhenat e bashkelidhura ne shkresat zyrtare te derguara edhe zyrtarisht nga avokati po ju nis edhe fotot e bera ne momentin fragrant te prerjes se pyllit. Kerkoj nga ana juaj te rishikohet ceshtja dhe te zbatohet ligji . Ju Faleminderit!	24.02.2026	Përshendetje , Në përgjigje të kërkesës suaj për informacion për veprimtarinë e shoqërisë “ASI RENT 2020” Sh.P.K., Ju bëjmë me dije si më poshtë vijon: IKMT, respektivisht Drejtoria e Inspektimeve të Pyjeve, më datë 26.01.2026, ngriti grupin e punës për verifikim në vend, ku rezultoi se veprimtaria e kësaj shoqërie vazhdon të jetë e pezulluar. Pasi u mor kontakti me administratorin, na informoi se hapja e rrugës është kryer nga një nënkontraktor, i cili ka kontratë shërbimi për kryerjen e punimeve për hapjen e rrugëve. Gjithashtu administratori paraqiti lejen e revokimit nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, si dhe	E plote	Nuk ka

				shprehu gadishmërinë për vënien në dispozicion të dokumentacionit, të cilat aktualisht i dispononte avokati, pasi ishin në proces gjyqësor. Gjithashtu administratori na informoi se shoqëria nuk ka filluar aktivitetin që nga marrja e lejes. Nëse dokumentacioni nuk na vendoset në dispozicion brenda afateve të përcaktuara, do të ndiqen procedurat e nevojshme ligjore, përt marrjen e masave administrative. Duke Ju falenderuar, Pershendetje, Në përgjigje të ankesës suaj, ju sqarojmë si më poshtë: 1. Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit, në bazë të urdhrit të Kryeinspektorit, më datë 03.03.2026, kreu inspektim në vendin e quajtur Brataj, ekonomia pyjore Mali i Bratit–Gumenicë, ngastra 6/a, Bashkia Selenicë. 2. Nga inspektimi i ushtruar në terren, u verifikua sipërfaqja e dëmtuar/prerë nga subjekti “Asi Rent 2020” sh.p.k.		
--	--	--	--	---	--	--

				3. Për shkeljen në fjalë, ndaj subjektit është marrë masë administrative nga Bashkia Selenicë, konkretisht dënim me gjobë dhe pezullim i aktivitetit minerar. Duke qenë se ndaj subjektit është marrë masë administrative (dënim me gjobë dhe pezullim i aktivitetit) nga Bashkia Selenicë, ju informojmë se nuk mund të merret masë administrative dy herë për të njëjtën shkelje. Nëse përsëri konstatoni ndërhyrje në zonë, jeni të lutur të na informoni. Duke ju falënderuar për mirëkuptimin!		
06	03.02.2026	Pershendetje, Gjeni bashkelidhur kërkesën për informacion dhe vënien në dispozicion të dokumentacionit: per subjektin “Vokopola Energji”sh.p.k	12.02.2026	Përschendetje, Në përgjigje të kërkesës tuaj për informacion, ju bëjmë me dije si më poshtë: IKMT, respektivisht Drejtoria e Inspektimeve në Mjedis dhe Ujëra, ka realizuar në subjektin “Vokopola Energji” sh.p.k., me një inspektim		

		Ne pritje te pergjigjes Tuaj brenda afatit ligjor .		shkresor 2-ditor, nëpërmjet platformës unike E-Inspektimi, me numër çështjeje NR.IKMT-DQ-2025-00014-1, me datë 17.07.2025 dhe 18.07.2025, me objekt inspektimi: “Verifikim mbi zbatueshmërinë e legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e mjedisit dhe ligjit ‘Për Burimet Ujore’”. Në përfundim të këtij inspektimi, bazuar në rezultatet e dala, është mbajtur edhe Vendimi Përfundimtar i Inspektimit, pa masë administrative, NR.IKMT-DQ-2025-00014-5, datë 18.07.2025. Subjekti i inspektuar “Vokopola Energji” sh.p.k, ka në përdorim dhe shfrytëzim tre (3) HEC-e, të cilët janë ndërtuar në Basenin Ujor Seman. Të tre këto vepra të prodhimit të hidroenergjisë janë të pajisura me Leje të Përdorimit të Burimit Ujor me qëllim për Prodhim Energjie, e përkatësisht: 1. L.U. Nr. serie 19, Nr.1616/1.Prot, datë 09.12.2020, miratuar me vendim të K.B.U. Seman, afat deri në vitin 2048, koordinata KRGJSH, centrali X=4210523856, Y=4487004,6905, Z=242.	
--	--	---	--	--	--

				2. L.U. Nr. serie 20, Nr.1617/1.Prot, datë 09.12.2020, miratuar me vendim të K.B.U. Seman, afat deri në vitin 2048, koordinata KRGJSH, centrali X=4237254335, Y=44910870523, Z=170. 3. L.U. Nr. serie 63, Nr.496.Prot, datë 07.07.2022, miratuar me vendim të K.B.U. Seman, afat deri në vitin 2048, koordinata KRGJSH, centrali X=501959.9, Y=4483957.3, Z=440.35 m n.m.d. Duke ju falënderuar për mirëkuptimin!		
07	04.02.2026	Përshëndetje, Po ju drejtohem lidhur me ankesën time për ndotje mjedisore dhe stalla me bagëti pranë banesave, e regjistruar me nr. çështjeje 920748, e cila është përcjellë për verifikim pranë institucionit tuaj. Deri në këtë moment, përveç njoftimeve automatike se çështja “po trajtohet”, nuk ka pasur asnjë ndërhyrje konkrete në terren, ndërkohë që problemi vazhdon dhe po përkeqësohet çdo ditë.	25.02.2026	Përshëndetje, Në përgjigje të kërkesës suaj për informacion, ju bëjmë me dije si më poshtë: IKMT – Drejtoria Rajonale Durrës, Sektori i Mjedisit dhe Ujërave, është paraqitur në terren për të kryer verifikimet përkatëse, nga ku u konstatua prezenca e dy stallave të ndodhura në një zonë rurale, në fshatin Rrushkull, Njësia	E plote	Nuk ka

		Stallat me bagëti ndodhen shumë pranë shtëpive ku banojnë mbi 11 familje dhe po shkaktojnë: • ndotje të rëndë mjedisore, • erë të padurueshme dhe mbetje, • zhurmë të vazhdueshme, • rrezik real për shëndetin e banorëve. Duke qenë se janë konsumuar edhe ankesat pranë pushtetit vendor pa asnjë rezultat, ju lutem të kryeni sa më parë verifikimin në terren dhe të na informoni konkretisht për hapat që do të ndërmerren dhe afatet për zgjidhjen e kësaj situate. Mbetem në dispozicion për çdo informacion shtesë dhe jam i gatshëm të bashkëpunoj për sqarime apo prova të mëtejshme. Ju falënderoj për vëmendjen dhe pres një reagim konkret nga ana juaj. Me respekt,		Nga ana e Drejtorisë Rajonale Durrës, duke qenë se, referuar numrit të kafshëve të imta që disponojnë, nuk përmbushet kriteri i përcaktuar në Shtojcën 1 të Ligjit nr. 52/2020, “Për disa ndryshime në Ligjin nr. 10448, datë 14.07.2011, ‘Për lejet e mjedisit’, të ndryshuar”, nuk është objekt për pajisje me Leje Mjedisi. Si rrjedhojë, nuk përbën kundërvajtje administrative, pasi nuk përmbushet kapaciteti prej më shumë se 50 (njësi) vende gjedhi të konvertuara. Ju bëjmë me dije se: Për kryerjen e verifikimeve në lidhje me plotësimin e kushteve konform Ligjit nr. 9426, datë 06.10.2005, “Për mbarështimin e blegtorisë”, çështja është deleguar për kompetencë pranë Drejtorisë Bujqësore Durrës, si dhe Bashkisë Durrës. Gjithashtu, IMT – Bashkia Durrës është ngarkuar për verifikimin e ligjshmërisë së objektit që është subjekt i kësaj ankese. Faleminderit.		
08	09.02.2026	Të nderuar, Në cilësinë e përfaqësuesit ligjor të një subjekti që ushtron aktivitet	23.02.2026	Përsëndetje, Në përgjigje të ankesës suaj paraqitur pranë Koordinatorit për të	E plote	Nuk ka

		në qytetin e Korçës, po ju drejtohem për të paraqitur një ankesë zyrtare lidhur me shkeljen e të drejtave të subjektit gjatë një veprimi të pretenduar inspektues. Në datën 09.02.2026, pranë ambienteve të aktivitetit janë paraqitur disa persona që janë prezantuar verbalisht si inspektorë, pa paraqitur asnjë dokumentacion identifikues apo autorizues, konkretisht: • pa urdhër pune, • pa bexhë identifikimi, • pa veshje zyrtare apo jelek me logo të institucionit përkatës (IKMT), • pa asnjë dokument që të vërtetonte statusin e tyre zyrtar. • makine me targa te huaja gjermane Personat në fjalë kanë tentuar të kryejnë veprime me natyrë inspektuese, duke krijuar pasiguri juridike dhe duke cenuar të drejtat e subjektit. Siç evidentohet edhe nga fotot/video bashkëngjitur, mungon çdo element identifikues zyrtar, në kundërshtim të hapur me procedurat ligjore të inspektimit si dhe komunikim		Drejtën e Informimit, ju bëjmë me dije sa vijon: Pas shqyrtimit të ankesës dhe pamjeve filmike të dërguara nga ana juaj, si dhe bazuar në informacionin e dhënë nga inspektorët e DRIKMT Korçë, rezulton se punonjësit e institucionit kanë kryer një verifikim të menjëhershëm në terren, pasi është konstatuar prania e një sasie gomash të përdorura të hedhura në një parcelë bujqësore. Gjatë verifikimit, u kërkua që gomat të hiqeshin dhe të depozitoheshin brenda objektit ku ushtrohet aktiviteti, pasi situata përbënte ndotje mjedisore. Në këtë rast nuk është ushtruar kontroll administrativ, pasi nuk është kërkuar dokumentacion apo të jetë mbajtur procesverbal. Për sa i përket ankesës lidhur me mungesën e jelekeve gjatë verifikimit, sqarojmë se kushtet klimatike kanë qenë jo të favorshme, çka ka ndikuar në mosmbajtjen e uniformës. Megjithatë, ju bëjmë me dije se inspektorëve u është tërhequr vëmendja për shkak të moszbatimit të rregullave të etikës.	
--	--	--	--	---	--

		verbal ne forme presioni te ushtruar ndaj punonjesve pa kerkuar pranine e administratorit te subjektit. Bazuar në legjislacionin në fuqi, çdo inspektim është i vlefshëm vetëm nëse kryhet me urdhër pune dhe nga inspektorë të identifikueshëm, ndaj çdo veprim i kryer në këto kushte konsiderohet i pavlefshëm dhe i paligjshëm. Në këtë kuadër, kërkoj: 1. Verifikimin zyrtar të personave që janë paraqitur si inspektorë. 2. Konstatimin e paligjshmërisë së veprimeve të kryera. 3. Marrjen e masave përkatëse administrative, nëse konstatohet shkelje. 4. Garanci që çdo inspektim i ardhshëm të kryhet vetëm në përputhje me ligjin. 5. Informimin tim me shkrim mbi përfundimet e shqyrtimit të kësaj ankese. Ju falënderoj për vëmendjen dhe mbetem në pritje të përgjigjes suaj zyrtare.		Ju falënderojmë.		
--	--	---	--	------------------	--	--

		Me respekt,				
09	12.02.2026	Pershendetje, Bashkelidhur ankesen time.	13.02.2026	Pershendetje, Drejtuar: Inspektoriati i Kontrollit dhe Mbrojtjes së Territorit, Bashkisë Vlorë Për dijeni: Në adresën e-mailit të koordinаторit të të drejtës për informim, IKMT, është paraqitur kërkesa, për informacion mbështetur në Ligjin nr. 119/2014, datë 18.09.2014 “Për të drejtën e informimit”. Bashkëlidhur po Ju përcjellim për kompetencë kërkesën sipas ligjit të sipërcituar paraqitur për verifikim dhe trajtim nga ana Juaj. Faleminderit!	Deleguar IMT Bashkia Vlore	Nuk ka
10	16.02.2026	Ju lutem vini në dispozicion numrin e kontrolleve të kryera ndaj subjekteve që ushtrojnë aktivitet shfrytëzimi pyjor (për prerjen) 1. Numri dhe vlera e gjobave të vendosura për shkelje ligjore në fondin pyjor.	03.03.2026	Pershendetje, Në vijim të kërkesës për informacion në lidhje me numrin e kontrolleve të kryera ndaj subjekteve që ushtrojnë aktivitet shfrytëzimi pyjor, Ju bëjmë me dije si më poshtë vijon: Gjatë viteve 2023, 2024 dhe deri në Tetor të Vitit 2025, Drejtoria e Inspektimit të Pyjeve, në bazë të Udhëzimit Nr.17, datë 20.4.2023,	E plote	Nuk ka

		2. Lloji i shkeljeve të konstatuara (p.sh. prerje jashtë parcelës, tejkalim volumesh, mungesë dokumentacioni, transport i paligjshëm etj). 3. Numri i rasteve të prerjeve të paligjshme të konstatuara dhe masat e marra. 4. Rastet e pezullimit apo heqjes së licencës ndaj operatorëve për shkelje të legjislacionit pyjor. 5. Rastet e referuara për ndjekje penale.		“Për bashkërendimin e funksioneve inspektuese në fushën e mbrojtjes së pyjeve”, nga IP është hequr akses i IKMT tek portali unik “e-inspektimi”. Por IKMT në referencë të VKM Nr.893/2015 <i>‘Për organizimin e funksionimit të IKMT’</i> dhe Urdhrit Nr 22, datë 3.2.2020 të Kryeministrit, “Për miratimin e strukture dhe organikës së IKMT”, ka jo vetëm kompetencë por detyrë: Kontrollin, mbrojtjen e territorit dhe të peizazhit nga ndërhyrjet dhe zhvillimet e kundërligjshme, duke garantuar një zhvillim të qëndrueshëm e të sigurt në fushën e zhvillimit, të planifikimit, të mbrojtjes së territorit, të tokës, të ajrit, të ujërave dhe të pyjeve, të disiplinimit të punimeve në ndërtim, si dhe në fushën e menaxhimit të integruar të burimeve ujore.”. Drejtoria e Inspektimit të Pyjeve ka ushtruar detyrat inspektuese pranë Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit, në zbatim të VKM Nr.604, datë 20.10.2021, “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë Shtetërore të Ministrisë së Brendshme”.	
--	--	---	--	--	--

				Referuar këtyre detyrave, gjatë Vitit 2023 janë realizuar në rang kombëtar 1001 inspektime, Për periudhën Janar-Prill 2023, nga Drejtoria e Inspektimit të Pyjeve janë mbajtur 13 Vendime “Dënim me gjobë”, të vëna në fushën e pyjeve. Numri i rasteve të referuara për ndjekje penale është 20. Gjatë Vitit 2024 nga Drejtoria e Inspektimit të Pyjeve janë realizuar në rang kombëtar 1623 inspektime, ku janë mbajtur 2 Vendime “Dënim me gjobë”, të vëna në fushën e pyjeve. Numri i rasteve të referuara për ndjekje penale është 2. Gjatë Vitit 2025 nga Drejtoria e Inspektimit të Pyjeve janë realizuar në rang kombëtar 1045 inspektime, ku janë mbajtur 9 Vendime “Dënim me gjobë”, të vëna në fushën e pyjeve. Numri i rasteve të referuara për ndjekje penale është 0. Kryesisht masat e mbajtura nga Drejtoria e Pyjeve konsistojnë në transport të paligjshëm të materialit drusor, pa dokumentacion shoqërues tekniko-ligjor, gjermime në fond pyjor, si dhe gjueti. Duke ju falenderuar,		
--	--	--	--	--	--	--

11	18.02.2026	Pershendetje, Bashkelidhur ankesen time.	18.02.2026	Përschendetje , Drejtuar: Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit, Bashkisë Lezhë Në dijeni:. Në adresëne-mai e lit të koordinatorit të të drejtës për informim, IKMT, është paraqitur kërkesa , me nr. 11 Rendor, datë 18.02.2026 Bashkelidhur po ju përcjellim kërkesën e paraqitur. Lutemi në trajtimin e kërkesës së sipërcituar. Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,	Deleguar IMT Bashkia Lezhe	Nuk ka
12	19.02.2026	Pershendetje, Bashkelidhur ankesen time	20.02.2026	Përschendetje, Më poshtë do të gjeni përgjigjen e Bashkisë Tiranë. Faleminderit. <i>Përschendetje</i> <i>Në përgjigje të ankesës së ardhur me e-mail, ju bëjmë me dije se:</i>		

				<i>Pas kontrollit të ushtruar nga punonjësit e Policisë Bashkiake në Njësinë Administrative Nr. 10, rruga “Reshit Çollaku”, Bashkia Tiranë, ju informojmë se në momentin e kontrollit nuk është konstatuar tejkalim i hapësirës publike.</i> <i>Lidhur me pretendimin se ka nderyrje në strukturen e pallatit, instalacionet dhe tubin e aspirimit të vendosura nga ky subjekt, nëpërmjet Sallës së Drejtimit dhe Koordinimit është njoftuar Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit (IMT) për verifikimin dhe ndjekjen e problematikës, sipas kompetencave të tyre ligjore.</i> <i>Duke ju falenderuar.</i>		
13	24.02.2026	Kërkoj të më vihen në dispozicion informacioni dhe dokumentat e mëposhtëm për lumenjtë dhe përrenjtë kryesorë të Parkut Shebenik–Jabllanicë: 1. Sa inspektime janë kryer nga IKMT në territorin e Parkut Shebenik–Jabllanicë nga viti 2018 deri	03.03.2026	Përsëendetje, Bashkëlidhur po ju dërgojmë përgjigjen ndaj kërkesës për informacion. Faleminderit.	E plote	Nuk ka

		sot? 2. Sa masa administrative (gjobë, pezullim, paralajmërim) janë vendosur për: ○ shkelje të rrjedhës ekologjike ○ devijime të paligjshme uji? 3. Ju lutemi të na vini në dispozicion: ○ kopje të vendimeve të gjobave ○ procesverbalet përkatëse (me të dhëna personale të anonimizuara). 4. A ka IKMT akses në vetëmonitorimet mjedisore periodike të dorëzuara në AKM nga subjektet e ndryshme në këtë park apo rang territori?				
14	23.02.2026	Përsëndetje, Në cilësinë e përfaqësuesit ligjor të subjektit ju falënderojmë për përgjigjen tuaj dhe për shqyrtimin e ankesës sonë lidhur me verifikimin e kryer nga persona të	06.03.2026	Përsëndetje, Bashkëlidhur gjeni përgjigjen për kërkesën. Faleminderit.	E plote	Nuk ka

		prezantuar si inspektorë të IKMT Rajoni Korçë, në datën 09.02.2026. Vlerësojmë angazhimin tuaj dhe sqarimet e dhëna. Megjithatë, në funksion të një kuptimi sa më të plotë dhe korrekt të situatës, dëshirojmë të paraqesim disa sqarime dhe konsiderata shtesë. Gjatë paraqitjes së personave në ambientet e subjektit tonë, nuk është paraqitur urdhër pune, dokument identifikimi zyrtar apo dokument autorizues që provon cilësinë funksionale, si dhe nuk janë mbajtur shenja dalluese apo uniformë (për të cilin kemi marrë sqarimin përkatës por justifikues). Në këtë kontekst, ushtrimi i pretenduar i funksionit inspektues është perceptuar në kundërshtim me standardet bazë të identifikimit dhe transparencës që duhet të shoqërojnë çdo veprim administrativ. Gjithashtu, mënyra e komunikimit dhe sjellja e mbajtur ndaj përfaqësuesve të subjektit u perceptua me tone joetike dhe urdhëruese, pa respektim të				
--	--	--	--	--	--	--

		parimit të trajtimit korrekt dhe proporcional, çka përbën edhe arsyen kryesore që na shtyu në paraqitjen e kësaj ankese. Dëshirojmë të theksojmë se kjo është hera e parë që subjekti ynë paraqet një ankesë të tillë, pavarësisht se kemi pasur edhe një verifikim të mëparshëm nga e njëjta zyrë gjatë muajit Tetor 2025. Në atë rast, për shkak të mungesës së provave filmike, nuk kemi vijuar me ankesë formale. Nga ana tjetër, lidhur me konstatimin e disa mbetjeve (goma të përdorura), sqarojmë se ato ndodhen në një parcelë jashtë pronës dhe administrimit të subjektit tonë, dhe për rrjedhojë çdo lidhje e krijuar midis subjektit dhe këtyre mbetjeve është e pabazuar dhe cenon reputacionin e tij. Për sa më sipër, do të vlerësonim një rishqyrtim të plotë të rastit, si dhe: Verifikimin e respektimit të detyrimit për identifikim dhe autorizim;				
--	--	--	--	--	--	--

		Sqarimin e bazës ligjore mbi të cilën është kryer verifikimi në terren; Vlerësimin e respektimit të standardeve të etikës së funksionarit publik; Identifikimin zyrtar të personave të përfshirë; Informimin me shkrim mbi përfundimet e shqyrtimit. Duke qenë se kjo është ankesa e parë e paraqitur nga ana jonë, shpresojmë që të mbetet edhe e fundit, pasi situata konkrete – komunikimi joetik dhe paraqitja jashtë protokolleve të rregullta – ishte arsyeja që na detyroi të ndërmarrim këtë hap. Mbetemi të hapur për bashkëpunim dhe mirëkuptim reciprok, në funksion të respektimit të ligjit dhe standardeve institucionale. Me respekt,				
15	25.02.2026	Në bazë të ligjit nr.119/2014	11.03.2026	Përsëndetje,	E plote	Nuk ka

		“Për të drejtën e informimit”, kërkojmë vënien në dispozicion të dokumentacionit si më poshtë: 1. Informacion nëse Inspektoriati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit ka ushtruar kontrolle në terren gjatë realizimit të punimeve ndërtimore të projektit “Manastiri Resort”, Gjiri i Manastirit, Bashkia Sarandë. 2. Në rast se janë ushtruar kontrolle, kopje të: procesverbaleve të inspektimit, raporteve të kontrollit në terren, konstatimeve administrative të hartuara nga inspektorët. 3. Dokumentacion mbi çdo masë administrative të ndërmarrë nga IKMT lidhur me punimet ndërtimore të këtij objekti. 4. Çdo urdhër pezullimi punimesh, vendim administrativ ose akt tjetër të nxjerrë nga IKMT në lidhje me realizimin e projektit. 5. Dokumentacion fotografik ose material tjetër shoqërues i hartuar gjatë kontrolleve në terren.	Në vijim të kërkesës suaj për informacion, ju dërgoj përgjigjen zyrtare. Dokumenti i bashkëngjitur përmban të gjithë informacionin e detajuar. Ju falënderoj për mirëkuptimin.		
--	--	---	--	--	--

		6. Çdo komunikim institucional i zhvilluar nga IKMT me autoritete të tjera shtetërore lidhur me kontrollet ndërtimore të ushtruara për këtë objekt.				
16	24.02.2026	Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit 1. A ka kryer IKMT inspektime në kantierin e ndërtimit të aksit Rrogozhinë - Elbasan gjatë periudhës së realizimit të punimeve? 2. Nëse po, ju lutem të na vini në dispozicion informacion mbi numrin e inspektimeve të kryera dhe konstatimet kryesore administrative. 3. A janë evidentuar masa administrative, rekomandime teknike apo ndërprerje të përkohshme punimesh gjatë realizimit të projektit?	10.03.2026	Përsëndetje, Në vijim të kërkesës suaj për informacion, ju dërgoj përgjigjen zyrtare lidhur me inspektimet në kantierin e aksit rrugor Rrogozhinë–Elbasan. Dokumenti i bashkëngjitur përmban të gjithë informacionin e detajuar. Ju falënderoj,	E plote	Nuk ka
17	25.02.2026	Kërkesë për inspektim urgjent dhe pezullim punimesh ndërtimore pranë pallatit tonë”. : I. RRETHANAT FAKTIKE Punimet në objektin shumëkatësh kanë rifilluar me intensitet të lartë pas një periudhe ndërprerjeje.	30.03.2026	Pershendetje, Bashkelidhur po ju dergojme kthimin e pergjigjes se ankeses suaj. Faleminderit.	E plote	Nuk ka

		Aktualisht: • Po kryhen gërmime për tre kate nën tokë në distancë kritike nga pallati ekzistues; • Është dëmtuar infrastruktura ekzistuese e ujërave të bardha dhe të zeza; • Është cenuar sistemi ekzistues i drenazhimit; • Punimet zhvillohen në terren të pjerrët; • Ndërtesa e re e rrethon pallatin tonë në tre drejtime. Këto rrethana krijojnë rrezik real për destabilizim strukturor dhe përmbytje. II. BAZA LIGJORE Referuar: • Ligjit nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit” • VKM nr. 408/2015 “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit” • Detyrimit ligjor për garantimin e sigurisë së objekteve fqinje • Detyrimit për mbrojtjen e infrastrukturës publike				
--	--	---	--	--	--	--

		Ndërtimi nuk duhet të cenojë sigurinë strukturore të objekteve ekzistuese dhe as të dëmtojë rrjetet publike. Dëmtimi i rrjetit të ujërave përbën shkak të mjaftueshëm për pezullim të menjëhershëm të punimeve deri në verifikim të plotë teknik. III. KËRKESAT Kërkojmë: 1. Inspektim urgjent në terren; 2. Pezullim të menjëhershëm të punimeve; 3. Verifikim të përputhshmërisë së punimeve me projektin e miratuar; 4. Vlerësim të sigurisë strukturore të pallatit ekzistues; 5. Verifikim të dëmtimit të infrastrukturës publike. Situata paraqet emergjencë reale dhe kërkon ndërhyrje të menjëhershme. Lidhur me sa më sipër, ankesa jonë është dërguar edhe me postë (bashkangjitur kopie) tek ju dhe dega rajonale e Vlorës, por				
--	--	---	--	--	--	--

		emergjenca e imponon edhe këtë komunikim. Faleminderit!				
18	24.02.2026	Në të njëjtin kat ndodhen edhe tre njësi të tjera tregtare, të cilat janë në pronësi të një subjekti tjetër. Ky i fundit ka kryer ndërhyrje të njëanshme duke spostuar muret ndarëse dhe duke zaptuar korridorin e përbashkët të katit, duke e përfshirë atë në përdorim të njërive të tij. Si pasojë, më është bllokuar dhe penguar akses i lirë për të hyrë në pronën time, duke cënuar drejtpërdrejtë të drejtën time të pronësisë dhe ushtrimin e aktivitetit tregtar. Theksoj se korridori është pjesë e përbashkët e ndërtesës dhe sipas legjislacionit në fuqi për bashkëpronësinë, nuk mund të tjetërsohet apo të përvetësohet nga asnjë bashkëpronar. Në këto kushte, kërkoj: Verifikimin urgjent në terren nga ana e strukturave kompetente; Konstatimin e shkeljes dhe marrjen e masave administrative përkatëse; Lirimin e menjëhershëm të hapësirës të përbashkët (korridorit);	25.02.2026	Përsëndetje , Drejtuar: Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit, Bashkisë Lezhë Në dijeni: Në adresën e mailit të koordinators të të drejtës për informim, IKMT, është paraqitur kërkesa nga, me nr. 18 Rendor, datë 24.02.2026 Bashkëlidhur po ju përcjellim kërkesën e paraqitur. Lutemi në trajtimin e kërkesës së sipërcituar. Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,	E plote	Nuk ka

		Rivendosjen e gjendjes së mëparshme sipas projektit dhe dokumentacionit të miratuar.				
19	28.02.2026	Pershendetje, Në faqen e pallatit ku ndodhet pjesa jonë e banimit, është ndërtuar një ashensor pa leje dhe pa miratimin apo firmën e asnjë prej banorëve. Disa banorë kanë kryer shtesa ndërtimore mbi tarracë, të cilat po na shkaktojnë probleme të vazhdueshme strukturore dhe shqetësime serioze. Jemi njoftuar gjithashtu për një vendim për ndërtimin e një ashensori brenda pallatit. Nga verifikimet tona rezulton se masat dhe hapësirat nuk përputhen me kushtet teknike, duke rrezikuar spostimin e shkallëve dhe sigurinë e banorëve. Theksojmë se kjo ndërhyrje po kryhet pa dakordësinë e banorëve të pallatit. Të gjitha këto veprime janë kryer pa transparencë dhe pa respektuar të drejtat e banorëve.	03.03.2026	Përshendetje, Drejtuar: IMT Bashkia Durrës Për dijeni: Në adresën e-mailit të koordinаторit të të drejtës për informim, IKMT, është paraqitur kërkesa. Bashkëlidhur po Ju përcjellim për kompetencë kërkesën për verifikim dhe trajtim nga ana Juaj. Faleminderit.	E plote	Nuk ka

		Ju lutemi të na ndihmoni dhe të ndërhyni për verifikimin e situatës dhe marrjen e masave të nevojshme, duke pasur parasysh se ne nuk jetojmë aktualisht në Shqipëri dhe e kemi të pamundur të ndjekim çështjen nga afër. Kemi besim të plotë tek ju për trajtimin korrekt të kësaj situate. Faleminderit për vëmendjen dhe mbetemi në pritje të një përgjigjeje.				
20	28.02.2026	Të nderuar, Nëpërmjet këtij emaili paraqes një ankesë zyrtare në emër të banorëve të Lagjes 15, zona Spitallë, Durrës, lidhur me një aktivitet grumbullimi dhe përpunimi kromi (rifuxho) që po zhvillohet prej vitesh në një zonë të banuar. Ky aktivitet zhvillohet shumë pranë banesave tona (rreth 20 metra larg), ku jetojnë fëmijë, të moshuar dhe familje të shumta. Kamionë me tonazh të rëndë hyjnë vazhdimisht në lagje, duke kaluar rreth 1 metër pranë shtëpive tona, me shpejtësi të lartë dhe me zhurmë të	09.04.2026	Përshëndetje, Në bashkëlidhje do të gjeni përgjigjen lidhur me kërkesën/ankesën tuaj. Ju falënderojmë për mirëkuptimin.	E plote	Nuk ka

		tmerrshme, duke rrezikuar seriozisht jetën dhe sigurinë tonë. Problemet kryesore janë: - Ndotje e rëndë e ajrit (tymi, pluhur kromi, smog) - Zhurma të forta nga kamionët dhe makineritë që ngarkojnë/shkarkojnë kontenierë - Punë pa orar të caktuar, edhe gjatë natës deri në mëngjes - Përpunim i kromit në ambient të hapur, pa kapanone, pa filtra mbrojtës dhe pa masa mbrojtëse mjedisore - Probleme serioze me frymëmarrjen tek banorët Edhe pse kemi paraqitur ankesa të mëparshme, përgjigjja ka qenë se subjekti disponon leje mjedisore. Ne ngremë shqetësimin: si mund të jetë e mundur që një aktivitet i tillë i rëndë industrial të ketë leje mjedisore në një zonë kaq të populluar, ku shtëpitë janë vetëm disa metra larg vendit të përpunimit? Kërkojmë urgjentisht: 1. Verifikim në terren nga një inspektor për të parë situatën nga afër.				
--	--	--	--	--	--	--

		2. Ndryshimin e menjëhershëm të trasës së lëvizjes së kamionëve, pasi ka alternativa të tjera rrugore. 3. Detyrimin e subjektit për ndërtimin e kapanonit të mbyllur për përpunimin e kromit. 4. Respektimin e orarit zyrtar të punës (08:00 – 16:00). 5. Zhvendosjen e kontenierëve dhe makinerive larg zonës së banimit. Jemi mbi 100 familje të rrezikuara dhe kërkojmë ndërhyrje të menjëhershme nga autoritetet për mbrojtjen e shëndetit dhe sigurisë sonë. Në pritje të një reagimi urgjent,				
21	09.03.2026	Për të pasqyruar në mënyrë objektive çdo zhvillim, Jemi te interesuar të marrë një reagim zyrtar nga Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit (IKMT) lidhur me çështjet e ngritura publikisht për këtë projekt. Më poshtë gjeni disa pyetje që do jenë në funksion të artikullit: 1. A ka kryer Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit	26.03.2026	Përsëndetje, Bashkëlidhur gjeni përgjigjen lidhur me kërkesën tuaj për informacion. Ju faleminderit.	E plote	Nuk ka

		verifikime në terren ose në bashkëpunim me IMT Shkodër në zonën e Baks-Rrjollit gjatë marsit të 2025 pas denoncimeve të banor banorëve për nisjen e punimeve për projektin “Blue Borgo”? Nëse po, cilat kanë qenë konstatimet? 2. Duke qenë se sipas dokumenteve publike leja e ndërtimit rezulton e firmosur më 8 gusht 2025 dhe e zbardhur më 15 janar 2026, ndërsa banorët pretendojnë se punimet kanë nisur në mars 2025, si e vlerëson IKMT këtë situatë nga pikëpamja e legjislacionit për planifikimin dhe zhvillimin e territorit? A konsiderohen të ligjshme punimet paraprake që sipas banorëve kanë nisur në mars të 2025? 3. A është raportuar nga IMT Shkodër pranë IKMT ndonjë				
--	--	--	--	--	--	--

		konstatim për punime pa leje apo shkelje procedurash nga kompania që po zhvillon projektin? Nëse po, cilat masa administrative janë ndërmarrë? 4. Nëse konstatohet se punimet kanë nisur përpara perfundimit së procedurave ligjore për lejen e ndërtimit, cilat janë pasojat ligjore sipas legjislacionit? 5. A është depozituar pranë IKMT ndonjë kërkesë për verifikim apo inspektim lidhur me projektin turistik “Blue Borgo” në Baks-Rrjoll? Në rast se po, si e keni trajtuar?				
22	10.03.2026	Të nderuar! ju lutemi institucionit tuaj për vënie në dispozicion të dokumenteve/informacioneve të mëposhtme Më konkretisht: 1.Listën e plotë të kontrolleve dhe inspektimeve të kryera nga	27.03.2026	Përshëndetje, Bashkëlidhur gjeni përgjigjen lidhur me kërkesën tuaj për informacion. Ju faleminderit.	E plote	Nuk ka

		Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit (IKMT) gjatë pesë viteve të fundit lidhur me aktivitetin e nxjerrjes së inerteve apo gërmimeve në shtratin e lumenjve në territorin e Republikës së Shqipërisë. 2. Procesverbalet e inspektimit, akt-konstatimet dhe vendimet administrative të marra ndaj subjekteve që janë konstatuar në shkelje gjatë këtyre kontrolleve. 3. Listën e subjekteve ndaj të cilave janë vendosur masa administrative (gjobë, pezullim aktiviteti apo bllokim punimesh) për ndërhyrje të paligjshme në shtratin e lumenjve.				
23	03.03.2026	Të nderuar zonja dhe zotërinj, Nëpërmjet këtij emaili ju njoftoj se bashkëlidhur po ju përcjell një kërkesë zyrtare lidhur me një situatë me karakter urgjent që kërkon shqyrtim të menjëhershëm nga ana juaj. Aktualisht unë nuk futem lirshëm në banesën time. Fillimi i ndërtimit dhe prishja e murit rrethues pengon futjen me makinë në shtëpi.	12.03.2023	Përshëndetje, Bashkëngjitur gjeni përgjigjen e kërkesës për informacion. Faleminderit.	E plote	Nuk ka

		Duke qenë se gjendja është kritike dhe ekziston rrezik për pasoja të pariparueshme, ju lutem që kërkesa e bashkëngjitur të trajtohet me prioritet maksimal dhe të merren masat përkatëse në përputhje me kompetencat ligjore të institucionit tuaj. Në pritje të një reagimi sa më të shpejtë nga ana juaj.				
24	09.03.2026	Pershendetje! Doja një reagim nga institucioni juaj, sa i përket përdorimit të kateve të para dhe nëntokësore si parkingje me pagesë, në komplekse në ndërtim në Tiranë. -Sa kontrole janë ushtruar në pallatet në ndërtim, që katet e para janë kthyer në parkingje me pagesë? Çfarë keni konstatuar? -A lejohet ky aktivitet, a plotësojnë standardet e sigurisë dhe çfarë masash keni marrë si institucion? Shkrimin e kam për publikim për të enjten, nëse është e mundur që komentin tuaj ta kem brenda ditës së mërkurë.	25.03.2026	Deleguar IMT Bashkia Tiranë	E deleguar	Nuk ka

		Duke ju falenderuar për bashkëpunimin, mbetem në dispozicionin tuaj për cdo sqarim të metejshëm.				
25	17.03.2026	Pershendetje, Bashkelidhur po ju dergoj ankesen. Faleminderit.	01.04.2026	Pershendetje, Bashkelidhur po ju dergoj pergjigjen per ankesen e ardhur prane IKMT. Faleminderit.	E plote	Nuk ka
26	18.03.2026	Në zonën e Paskuqanit, pranë Bulevardit të Ri dhe buzë lumit të Tiranës, është duke u zhvilluar një ndërtim i madh që ngre shqetësime serioze mbi ligjshmërinë e tij. Ky rast është denoncuar pranë institucioneve përkatëse, përfshirë Policinë, Bashkinë Kamëz dhe IKMT, por deri më tani nuk ka pasur asnjë reagim apo ndërhyrje konkrete. Kërkohet transparencë dhe verifikim i menjëhershëm i situatës,	14.04.2026	Përsëndetje, Bashkelidhur do te gjeni pergjigjen. Faleminderit.	E Plote	Nuk ka

27	19.03.2026	Po ndërtohet një vilë 2-katëshe pa leje. Kërkohet verifikim dhe ndërhyrje e menjëhershme nga institucionet përgjegjëse.	08.05.2026	Përsëndetje, Në lidhje me ankesën tuaj, ju bëjmë me dije se DRIKMT Korçë, me shkresën nr. 174/4, e ka përcjellë atë për kompetencë pranë IMT-së së Bashkisë Kolonjë, për ndjekjen dhe trajtimin e mëtejshëm sipas kompetencave përkatëse. Bashkëlidhur gjeni edhe shkresën e dërguar nga DRIKMT Korçë. Faleminderit	E plote	Nuk ka
28	21.03.2026	Përsëndetje, Duke u mbështetur në Ligjin Nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit,” dhe në përputhje me nenet e këtij ligji, i cili rregullon të drejtën e njohjes me informacionin që prodhohet ose mbahet nga autoritetet publike, ju drejtohem me këtë kërkesë për të marrë informacionin e mëposhtëm në lidhje me projektin Durrës Yachts & Marina: A janë kryer inspektime në këtë zonë? Nëse po, lutemi të na vendosni në dispozicion një kopje të procesverbaleve të inspektimeve të kryera. A ka pasur konstatime teknike gjatë kontrolleve? Nëse po,	03.04.2026	Përsëndetje, Bashkëngjitur gjeni përgjigjen e kërkesës për informacion. Faleminderit.	E plote	Nuk ka

		lutemi të na vendosni në dispozicion një kopje të këtyre konstatimeve? Bazuar në detyrimet ligjore për transparencë dhe në të drejtën e qytetarëve për t'u informuar, presim që të na mundësoni informacionin e kërkuar brenda afatit të përcaktuar nga legjislacioni në fuqi. Duke ju falënderuar paraprakisht				
29	25.03.2026	Nëpërmjet këtij denoncimi, kërkoj verifikimin e menjëhershëm në terren për dy objekte që po ndërtohen në zonën e Ksamilit, të cilat dyshohet se janë në kundërshtim të plotë me legjislacionin në fuqi dhe pa leje ndërtimi. Nga verifikimet dhe vëzhgimet në terren, rezulton se: Janë ndërtuar struktura të qëndrueshme Punimet kanë vazhduar pa ndërprerje, pavarësisht mungesës së dokumentacionit të dukshëm ligjor Duke qenë se zona në fjalë është bregdetare dhe me rëndësi të veçantë publike, çdo ndërhyrje pa leje përbën shkelje të rëndë dhe	26.05.2026	Përrshëndetje, Ju bëjmë me dije se, në bazë të ankesës suaj drejtuar IKMT-së nga ana e Drejtorisë së Inspektimit të Territorit dhe Planifikimit, është mbajtur procedura e prishjes. Faleminderit për mirëkuptimin.	E plote	Nuk ka

		kërkon reagim të menjëhershëm nga autoritetet kompetente.				
30	26.03.2026	Subjekti xxxxxxx me Nipt xxxxxx ka ardhur ne pronen tone dhe ne vazhdim me fshatin xxxxxx, duke bere nje masaker mjedisore (prerje pylli) me qellim hapje kave guri . Prej atij momenti ne kemi jnoftuar inspektorin e policise se zones si dhe xxxxxx - xxxxxx dhe xxxxxx , por nuk na jane pergjigjur me asnje veprim ne terren apo proces verbal. Theksoj se ata kane dashur te mbrojne kolegun e tyre xxxxxx i cili punon ne xxxxxx, dhe qe njekohesisht eshte edhe aksioner ne shoqerine e lart permendur. Te njejten masaker mjedisore ky subjekt ka kryer edhe ne hyrje te fshatit xxxxxx - tek vendi i quajtur " xxxxxx " (xxxxxx). Me ane te kesaj ankese kerkoj nga ana e autoriteteve shteteroe , qe me anen e inspektoreve te tyre te verifikojne gjendjen ne terren dhe te marrin masat sipas legjislacionit ne fuqi. Prona private eshte e shenjte dhe shteti duhet ta garantoje ate. B/ lidhur gjeni foto si argument te ankeses se mesiperme	21.04.2026	Përsëndetje, Bashkëlidhur po ju dërgojmë përgjigjen ndaj kërkesës suaj për informacion. Faleminderit.	E plote	Nuk ka

		Jemi ne pritje te pergjigjes TUAJ. Faleminderit per mirkuptimin.				
31	26.03.2026	Pas shume ankesave dhe denoncimeve ne IKMT Pogradec nuk kam marre asnje lloj zgjidhje te ketij problemi prandaj po ju drejtohem ju si autoriteti me i larte . Deme te cilat po shkaktohen edhe nga mungesa e serjozitetit te institucioneve perkatese qe po lejojne kte paligjshmeri dhe duke mos marre parasysh ankesat e mia te vazhdueshme	28.04.2026	Përsëndetje, Bashkëngjitur gjeni përgjigjen e kërkesës për informacion. Faleminderit.	E plote	Nuk ka
32	26.03.2026	Ne lidhje me proces-verbalin nr. 14, date 25.03.2026, Ksamil, paraqes kete ankim administrativ brenda afatit ligjor, duke kundërshtuar konstatimin e bere nga inspektorët.	14.04.2026	Përsëndetje, Në lidhje me ankimimin e drejtuar pranë IKMT-së, në lidhje me procesverbalin nr. 14, datë 25.03.2026, ju bëjmë me dije sa më poshtë: Bazuar në ligjin nr 99/2024 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë” neni 55, Kundër vendimit përfundimtar të inspektimit, subjekti ka të drejtën e ankimimit brenda 30 ditëve nga data e njoftimit përfundimtar. Ankimi paraqitet pranë “Komisionit të Shqyrtimit të ankimit” në Inspektoratin e Përgjithshëm.	E plote	Nuk ka

				Ju falënderojmë për mirëkuptimin.		
33	30.03.2026	Lumi Terkuze buron ne Boville edhe derdhet ne Adriatik, qe nga Bovilla ku deri ne Rinas jane mbi 40 pika inertesh te gjitha pa leje...Zona e bukur pika turistike e Bovillesh po shembet me mina dhe dinamit per inerte.... eshte nje nga kanionet me te bukura te shqiperise.... e gjitha po shembet pa leje.... pastaj me poshte ka nje derdhje masive inertesh qe nga zall herri deri ne Kamez.... miliona ton dhe jane derdhur.... gjeresia e Lumit nga 300/400 metra eshte kthyer ne nje kanal vadites	01.04.2026	Përshëndetje, Duke ju konfirmuar se e-maili juaj është administruar, në funksion të verifikimit të të dhënave të paraqitura prej jush, ju informojmë se një grup inspektimi nga Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit (IKMT) do të autorizohet për të kryer verifikimet në terren. Grupi i inspektimit do të ndjekë procedurat përkatëse dhe do të vlerësojë situatën në përputhje me legjislacionin në fuqi. Për çdo zhvillim të mëtejshëm do të informoheni në vazhdim. Faleminderit për bashkëpunimin	Ne proces	
34	31.03.2026	Përshëndetje, Në kuadër të raportimit mediatik po ndjek një rast që lidhet me ndërtimin e një objekti banimi dhe shërbimesh në zonën e Ilirisë, në Plazh të Durrësit, për të cilin banorët e një godine ngjitur kanë ngritur shqetësime dhe ankesa. Konkretisht, godina me vendndodhje në “Rrugën	21.04.2026	Përshëndetje, Bashkëlidhur po ju dërgojmë përgjigjen ndaj kërkesës suaj për informacion. Faleminderit.	E plote	Nuk ka

		Pavarësia”, me subjekt zhvillues shoqëritë “AKM Group” sh.p.k. dhe “Bega-07” sh.p.k., është miratuar me vendim të KKTU-së nr. 26, datë 25.06.2025. Sipas tyre, ndërtimi nuk respekton distancat ligjore nga objekti ekzistues dhe mund të cenojë sigurinë e strukturës së godinës ku ata banojnë. Gjithashtu, ata pretendojnë se një hapësirë e konsideruar prej tyre si pronë private është paraqitur në dokumentacion si “rugicë ekzistuese”. Në këtë kuadër, do të vlerësonim një përgjigje nga ana juaj për këto çështje: A është kryer një verifikim nga institucioni juaj mbi këtë rast dhe cilat janë konstatimet? A rezulton që leja e ndërtimit të jetë në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe rregullat urbanistike, veçanërisht për distancat nga objektet ekzistuese? A është verifikuar statusi i pronësisë së hapësirës së				
--	--	--	--	--	--	--

		përmendur si “rrugicë ekzistuese” në dokumentacion? A ka pasur ndërhyrje apo shkelje gjatë fazës së zbatimit të punimeve dhe a janë marrë masa nga ana juaj? A parashikohet një rishikim i lejes së ndërtimit në këtë rast?				
35	01.04.2026	Pershendetje Doja te beja nje denoncim per nje ndertim pa leje qe po behet ne lagjen nr.1 Currila Durres. Asnje mase e marre nga institucionet e qarkut Durres. Pavarsisht se kemi marre disa dokume te dhe eshte vertetuar se eshte ndertim pa leje, perseri vazhdohet te punohet.	07.04.2026	Të nderuar! Në lidhje me ankesën e bashkëlidhur emailit, ju bëjmë me dije se: Për këtë objekt nga IMT Bashkia Durrës, është mbajtur Procesverbal për Konstatimin e Kundërvajtjes me nr. 17, datë 13.02.2023, me nr. serie 0001637, për ndërtimin "Objekt 1 kat me konstruksion metalik, me kolona metalike, mbi pllakë betoni". Në vijim, nga IMT Bashkia Durrës është nxjerrë vendimi për Prishjen e Objektit të Kundërligjshëm me nr. 30, datë 17.02.2026, me nr. serie 0002864, si dhe Vendimi për Dënimin me Gjobë me nr. 30, datë 17.02.2026 dhe nr. serie 0001881. Faleminderit.	E plote	Nuk ka

36	02.04.2026	Kërkesë urgjente për ndalimin e menjëhershëm të aktivitetit të paligjshëm të nxjerrjes së gurit në Malin e Gostënckës, Bashkia Skrapar. Subjekti:... Kërkohet verifikimi i ligjshmërisë dhe vlefshmërisë së lejeve false që përdoren nga Anesti Topi, në bashkëpunim me disa institucione dhe elementë të korruptuar.	09.04.2026	Përsëhendetje, Bashkëlidhur po ju dërgojmë përgjigjen ndaj kërkesës suaj për informacion. Faleminderit.	E plote	Nuk ka
37	03.04.2026	Pershemdetje, Bashkelidhur ankesen.	14.04.2026	Përsëhendetje, Bashkëlidhur gjeni përgjigjen lidhur me ankesën e paraqitur. Ju faleminderit	E plote	Nuk ka
38	04.04.3036	Leja është për strukture të lehta në plazh dhe hidhet hekur dhe beton. IVMT sarandë nuk kryen asnjë veprim.	14.04.2026	Përsëhendetje, Bashkëlidhur gjeni përgjigjen lidhur me ankesën e paraqitur. Ju faleminderit	E plote	Nuk ka
39	09.04.2026	Përsëhendetje të nderuar, Më poshtë po ju përcjellim një kërkesë për informacion lidhur me projektin turistik “Manastiri Resort”, i zhvilluar në zonën Gjiri i Manastirit, Bashkia Sarandë. Kërkesa lidhet me dokumentacionin institucional,	17.04.2026	Përsëhendetje, Ju përcjellim bashkëlidhur përgjigjen e kërkesës suaj. Faleminderit për mirëkuptim	E plote	Nuk ka

		aktivitetet e monitorimit dhe administrimit të territorit në lidhje me realizimin e këtij projekti në zonën e sipërcituar. Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,				
40	09.04.2026	Po ju drejtohem në lidhje me një problem serioz në lagjen ku banoj, i cili ka të bëjë me bllokimin e një rruge publike me emrin Vatikani ne lagjen 6 Bathore, bashkia Kamez nga disa individ privat. Kjo rrugë është përdorur prej vitesh nga banorët e zonës, por aktualisht njëri krah i saj është zënë në mënyrë të paligjshme, duke penguar qarkullimin normal dhe duke krijuar vështirësi për banorët, mjetet dhe shërbimet emergjente. Për këtë arsye, kërkoj me urgjencë ndërhyrjen e strukturave përkatëse dhe kryerjen e një inspektimi nga Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit (IKMT), për të verifikuar situatën dhe për të marrë masat ligjore të nevojshme për lirimin e hapësirës publike.	14.04.2026	Përsëndetje, Drejtuar: Inspektorati i Kontrollit dhe Mbrojtjes së Territorit, Bashkisë Kamëz. Për dijeni Në adresën e-mailit të koordinаторit të të drejtës për informim, IKMT, është paraqitur kërkesa nga Bashkëlidhur po Ju përcjellim për kompetencë kërkesën sipas ligjit. Faleminderit!	Deleguar IMT Bashkia Kamez	Nuk ka
41	14.04.2026	Ju shkruaj nga fshati Lin ne qytetin e Pogradecit	28.04.2026	Përsëndetje,	E plote	Nuk ka

		Ne qender te fshatit ndodhet nje subjekt i quajtur bar restornat hotel Leza ku prej dates 22 dhjetor i eshte prishur nje platforme betoni ne brendesi te liqenit si dhe ka zaptuar vijen liqenore deri ne brendesi, qysh prej asaj dite 22 dhjetor ne liqen gjenden akoma deri sot inertet sebashku me konstruksionet metalike (shina treni) Qellimi i mos heqjes se konstruksioneve eshte rindertimi i saj perseri dhe per kete subjekt cdo drejtori perkatese ose shkeput bisedimin ose i shmanget me arsye absurde nga (nuk kemi mjete perkatese, kushte atmosferike, projekte kompani te huaja, njera drejtori shprehet nuk eshte ne ngarkimin tone tjetera po ashtu)		Ju përcjellim bashkëlidhur përgjigjen e kërkesës suaj. Faleminderit për mirëkuptim		
42	15.04.2026	Nëpërmjet këtij emaili paraqes një kërkesë zyrtare për verifikimin e një ndërtimi që dyshohet të jetë kryer në kundërshtim me legjislacionin në fuqi për planifikimin dhe zhvillimin e territorit. Sipas informacioneve të disponueshme, në zonën Vorë – Prezë – Marikaj është realizuar	11.05.2026	Përshëndetje, Ju informojmë se ankesa juaj është përcjellë për kompetencë me shkresën nr. 250/1 pranë Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Bashkisë Vorë. Aktualisht jemi në pritje të përgjigjes nga IMT Bashkia Vorë. Bashkëlidhur po ju dërgojmë shkresën përkatëse.	E plote	Nuk ka

				Faleminderit		
43	16.04.2026	Kërkesë për inspektim urgjent, pezullim punimesh dhe verifikim të ligjshmërisë së ndërhyrjeve në një godinë banimi.	11.05.2026	Përsëndetje, Ju informojmë se ankesa juaj është përcjellë për kompetencë me shkresën nr. 251/2 pranë Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit, Bashkia Tiranë. Aktualisht jemi në pritje të përgjigjes nga IMT, Bashkia Tiranë. Bashkëlidhur po ju dërgojmë edhe shkresën përkatëse. Faleminderit	E plote	Nuk ka
44	06.04.2026	Malin midis Krujes dhe Tiranës, aty është një zonë që kategorikisht nuk lejohet germimi i gurorëve, edhe një nga zonat me te bukura edhe te virgjera te natyres shqiptare, Vargmalet ne Shqiperi jane terminalit mrekullueshme	22.04.2026	Përsëndetje, Ju përcjellim bashkëlidhur përgjigjen e kërkesës suaj. Faleminderit për mirëkuptim	E plote	Nuk ka
45	08.04.2026	Te nderuar Po ju drejtohem nëpërmjet këtij emaili për të paraqitur një ankesë lidhur me një situatë problematike që lidhet me shkeljen e territorit dhe mungesën e ndërhyrjes nga autoritetet përkatëse.	22.04.2026	Përsëndetje, Bazuar në ankesën e paraqitur pranë IKMT-së për zaptim të hapësirës publike, ju informojmë si më poshtë:	Ne proces	Nuk ka

		Në mënyrë konkrete, bëhet fjalë për: Zaptimin e hapsires publike ne Njesin Administrative Fierze - Tropoje pikerisht parcela 137 a me numer pasurie 72 prone e bashkise Tropoje. Jane rrethuar afersisht 12 ha hapsire e cila deri tani ka qene shfrytezuar per kullosa te bagetive nga baroret e zones e madje brenda rrethimit eshte edhe ish reparti ushtarak.		Drejtoria e Inspektimit të Pyjeve ka përcjellë shkresa pranë institucioneve përkatëse për të kërkuar informacion lidhur me ligjshmërinë e sipërfaqes ku është kryer ndërhyrja. Aktualisht jemi në pritje të përgjigjeve, në mënyrë që të vijojmë me hapat e mëtejshëm proceduralë. Faleminderit për mirëkuptimin.		
46	28.04.2026	Në vijim të kërkesës sonë për ndërhyrje lidhur me aktivitetin e paligjshëm të subjektit ... në Malin e Gostenckës, Bashkia Skrapar, jemi njohur me refuzimin tuaj, me arsyetimin se kjo çështje “nuk është objekt i punës së IKMT”. Ky qëndrim është ligjërisht i pabazuar dhe në kundërshtim të drejtpërdrejtë me detyrat funksionale të institucionit që ju drejtoni.	12.05.2026	Pershendetje, Bashkelidhur po ju dergoj pergjigjen per ankesen e ardhur prane IKMT. Faleminderit.	E plote	Nuk ka
47	29.04.2026	Përsëndetje! Po ju shkruajmë në emër të banorëve të fshatit Nartë,Vlorë	08.06.2026	Përsëndetje, Ju bëjmë me dije se ankesa juaj është deleguar për kompetencë	E plote	Nuk ka

		për një shqetësim të banorëve të fshatit tonë. Brenda zonës së banuar të fshatit tonë po ngrihet, ndërtohet, me ritme të shpejta pa leje ose “me Leje” një pik Grumbullimi Demontimi Automjetesh të vjetra “Me Bekimin e Autoriteteve Vendore”. Në atach keni. 1) Ankesën të detajuar 2) Pjesën nga Plani e Përgjithshëm Vendor 3) Tabelën Sqaruese të planit Vendor		pranë Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit, me shkresën nr. 284/3, datë 05.06.2026. Bashkëlidhur po ju dërgojmë shkresën. Faleminderit		
48	30.04.2026	Përhëndetje të nderuar, Më poshtë po ju përcjellim një kërkesë për informacion lidhur me projektin “Programi për Integrimin Urban dhe Zhvillimin e Turizmit (PIUTD)”, me fokus në ndërhyrjet infrastrukturore në zonën Sarandë–Ksamil, përfshirë bypass-in e Ksamilit. Kërkesa lidhet me projektimin teknik, zbatimin në terren, procedurat e ndjekura, si dhe dokumentacionin përkatës (teknik, mjedisor dhe administrativ) që lidhet me këtë projekt dhe ndërhyrjet e parashikuara në kuadër të tij.	12.05.2026	Pershendetje, Bashkelidhur po ju dergoj pergjigjen per ankesen e ardhur prane IKMT. Faleminderit.	E plote	Nuk ka

		Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,				
49	01.05.2026	Të nderuar drejtues të IKMT-së, Në vijim të materialeve të publikuara pasditen e së enjtes dhe gjatë ditës së premte në rrjetet sociale nga organizata mjedisore dhe aktivistë, ku pretendohet për zhvillim aktiviteteve ndërtimore brenda zonës së mbrojtur Pishë-Poro-Nartë (segmenti Akëri-Hidrovor), po ju drejtohem për një verifikim zyrtar dhe informacion të detajuar mbi situatën. Sipas pamjeve të publikuara, në zonë evidentohet lëvizje e mjeteve të rënda, hapje e një rruge të re dhe ndërhyrje në terren me ekskavatorë ku dukshëm	12.05.2026	Përsëndetje, Bashkëlidhur gjeni përgjigjen ndaj kërkesës për informacion. Faleminderit.	E plote	Nuk ka

		po ngrihet një kantier ndërtimi, ndërkohë që pretendohet se këto punime po zhvillohen pa një leje ndërtimi të bërë publike dhe brenda një territori me status të mbrojtur. Duke marrë në konsideratë rolin e Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit në kontrollin dhe ndalimin e ndërtimeve pa leje apo në kundërshtim me legjislacionin në fuqi, ju lutemi të na informoni mbi sa vijon: 1. A ka kryer IKMT ndonjë verifikim në terren në zonën Pishë-Poro-Nartë (Akërne-Hidrovor) në lidhje me këto pretendime? 2. Nëse po, cilat janë konstatimet paraprake dhe a është identifikuar ndonjë shkelje e legjislacionit për ndërtimet apo mbrojtjen e territorit?				
--	--	---	--	--	--	--

		3. A rezulton që për këto punime të jetë lëshuar një leje ndërtimi nga autoritetet përkatëse? Nëse po, cilat janë të dhënat kryesore të saj? 4. Në rast se punimet janë kryer pa leje, a janë marrë masa administrative (pezullim punimesh, gjoba, kallëzim penal)? 5. A ka identifikuar IKMT subjektin apo subjektet që po kryejnë këto punime? 6. A është bashkërenduar veprimi me institucione të tjera përgjegjëse, përfshirë ato mjedisore,				
50	04.05.2026	Ankese per IKMT	05.05.2026	Përsëndetje , Drejtuar: Inspektoriati i Kontrollit dhe Mbrojtjes së Territorit, Bashkisë Lushnjë Për dijeni Në adresën e-mailit të koordinatorit të të drejtës për informim, IKMT, është paraqitur kërkesa nga....	E plote Deleguar IMT Bashkia Lushnje	Nuk ka

				Bashkëlidhur po Ju përcjellim për kompetencë kërkesën sipas ligjit të paraqitur nga për verifikim dhe trajtim nga ana Juaj. Faleminderit,		
51	05.05.2026	Të nderuar drejtues të IKMT-së, Redaksia e Citizens.al po ndjek në vijimësi situatën e raportuar publikisht lidhur me ndërhyrjet në zonën kodrinore të Mifolit, Bashkia Vlorë, ku sipas raportimeve mediatike dhe denoncimeve publike janë kryer punime për marrje dhe transport të dherave apo materialeve inerte pa lejet përkatëse. Referuar raportimeve të mëparshme mediatike, por edhe verifikimeve të Citizens.al në terren, është ngritur shqetësimi se këto ndërhyrje janë kryer pa autorizim	13.05.2026	Përshëndetje, Në të kërkesës tuaj për informacion mbi aktivitetin e marrjes së dherave në zonën kodrinore të Mifolit, Vlorë, ju bëjmë me dije sa vijon: Referuar pyetjeve tuaja, IKMT-Drejtoria Rajonale Vlorë ka kryer inspektimin në zonën e Mifolit, më datë 28.01.2026. Gjatë këtij inspektimi janë konstatuar punime të kryera, si spostime dherash dhe ndryshime/ristrukturime të tokës, pa disponuar VNM paraprake, në kundërshtim me legjislacionin mjedisor në fuqi. Si pasojë, nga ana e IKMT- Drejtoria Rajonale Vlorë, janë vendosur masat administrative si më poshtë:	E plote	Nuk ka

		institucional dhe pa dokumentacion mjedisor, ndërkohë që materiali i nxjerrë dyshohet të jetë përdorur për punime në aeroportin e Vlorës. Në kuadër të një verifikimi në terren të realizuar së fundmi nga ana jonë (rreth 4 muaj pas raportimeve të para), kemi dokumentuar përmes materialeve fotografike gjendjen aktuale të zonës, ku evidentohet se: ndërhyrja në relievin kodrinor është e konsiderueshme, gjurmë aktiviteti dhe degradimi i terrenit mbeten të dukshme, ekzistojnë dyshime të arsyeshme se aktiviteti mund të ketë vijuar pa plane rehabilitimi të zonës. Zona në fjalë ndodhet në afërsi të koordinatave: 40°36'03.8"N 19°29'20.7"E (link Google).		-Gjoha administrative në vlerën 500,000 (pesëqind mijë) lekë, si dhe -Masa administrative plotësuese: pezullimi i punimeve. Ju informojmë se nga IKMT-Drejtoria Rajonale Vlorë nuk është depozituar kallëzim penal lidhur me këtë rast. Më tej, shoqëria Vlora International Airport ka vijuar sërish me punimet, duke paraqitur pranë DR-IKMT Vlorë njoftimin për fillimin e punimeve për sistemin e terrenit për zgjerimin e varrezave të fshatit Mifol, Njësia Administrative Novoselë, Bashkia Vlorë. Subjekti ka paraqitur gjithashtu vendimin e AKM, në të cilin përcaktohet se ndërhyrjet që kanë karakter sistemimi, mirëmbajtjeje apo rregullimi të terrenit, pa ngritje strukturash ndërtimore, nuk konsiderohen zhvillim ndërtimor sipas ligjit nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”. Në zbatim të ligjit nr. 10440, datë 07.07.2011 “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”, i ndryshuar, konstatohet se ndërhyrje të tilla nuk	
--	--	--	--	--	--

		Për sa më sipër, kërkojmë nga institucioni juaj informacionin si më poshtë: 1. A ka kryer IKMT inspektime në zonën e Mifolit për këtë rast? Nëse po, kërkojmë datat dhe kopje të procesverbaleve përkatëse. 2. Cilat shkelje janë konstatuar konkretisht nga inspektimet dhe cilat subjekte janë identifikuar si përgjegjëse? 3. Çfarë masash administrative janë marrë (pezullim punimesh, gjoba, sekuestrim mjetesh, etj.) dhe a janë ekzekutuar ato? 4. A është depozituar kallëzim penal për këtë rast? Nëse po, në cilën fazë ndodhet procedimi		i nënshtrohen procedurës së VNM-së. Bashkëngjitur, po ju vendosim në dispozicion: -Praktikën e mbajtur nga DR-IKMT Vlorë; -Njoftimin e fillimit të punimeve nga subjekti Vlorë International Airport; (Shkresën nr. 3434/1 prot., datë 25.02.2026 të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, me anë të së cilës konfirmohet se projekti nuk i nënshtrohet procedurës së VNM-së; Shkresën nr. 85, datë 23.01.2026 të Bashkisë Vlorë – Njësia Administrative Novoselë, me të cilën autorizohet marrja e materialit dheror në Mifol, në parcelën e përcaktuar për zgjerimin e varrezave) - Fotografi në terren. Duke ju falenderuar.		
52	05.05.2026	Sa asgjesime ka kryer subjekti “Gjirofarma ” me NIPT K43522610E nga janari 2020 deri në prill 2026 ?	22.05.2026	Përshëndetje, Bashkëlidhur do të gjeni kthim-përgjigjen në lidhje me kërkesën tuaj. Faleminderit.	E plote	Nuk ka

		Lutemi të na saktësoni datën, muajin, vitin kur janë kryer procedurat e asgjësimit. Cila ka qenë sasia përkatëse e asgjësuar për çdo procedurë? Në cilin vend/ambient janë kryer procedurat e asgjësimit Duke ju falenderuar për bashkëpunimin, mbetemi në pritje te përgjigjes nga ana juaj.				
53	05.05.2026	Përsëndetje, Duke uruar të jeni mirë, ju lutem gjeni bashkëlidhur kërkesën për informacion. Po ashtu, në përputhje me ligjin Nr.119/2014 Për të Drejtën e Informimit, bashkëngjitur keni edhe kartën e identitetit të skanuar. Mbetem në pritje të një përgjigjeje, Punë të mbarë,	06.05.2026	Përsëndetje , Drejtuar: Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit, Bashkisë Tiranë Për dijeni Znj. Në adresën e-mailit të koordinitorit të të drejtës për informim, është paraqitur kërkesa nga Znj., për informacion mbështetur në Ligjin nr. 119/2014, datë 18.09.2014 “Për të drejtën e informimit”. Bashkëlidhur po ju përcjellim për kompetencë kërkesën sipas ligjit të sipërcituar paraqitur nga për verifikim dhe trajtim nga ana juaj.	E plote Deleguar IMT Bashkia Tirane	Nuk ka

				Faleminderit!		
54	07.05.2026	Sa asgjesime ka kryer subjekti Rossmann-Lala me NIPT K81921001A nga janari 2020 deri në prill 2026 ? Lutemi të na saktësoni datën, muajin, vitin kur janë kryer procedurat e asgjesimit. Cila ka qenë sasia përkatëse e asgjësuar për çdo procedurë? Në cilin vend/ambient janë kryer procedurat e asgjësimit Duke ju falenderuar për bashkëpunimin, mbetemi në pritje te përgjigjes nga ana juaj.	22.05.2026	Përshëndetje, Bashkëlidhur do të gjeni kthim-përgjigjen në lidhje me kërkesën tuaj. Faleminderit.	E plote	Nuk ka
55	11.05.2026	Përshëndetje, Urojmë që ky email t'ju gjejë sa më mirë. Dëshirojmë të paraqesim dy lende kerkesash: një kërkesë për informacion dhe një për	12.05.2026	Përshëndetje, Bashkëlidhur gjeni përgjigjen e kërkesës për informacion. Faleminderit,	E plote	Nuk ka

		vendosjen/dorëzimin e dokumentacionit pranë IKMT. Bashkëngjitur do të gjeni dokumentacionin përkatës për shqyrtim. Në pritje të përgjigjes suaj, ju falenderojmë paraprakisht për bashkëpunimin. Me respekt,				
56	22.05.2026	Në kuadër të transparencës publike, duke u bazuar tek ligji nr. 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit” i ndryshuar, emisioni “Vetting” kërkon si informacion: 1. Numrin e kontrolleve të kryera në lumin Mat gjatë viteve 2023–2025. 2. Numrin e subjekteve të konstatuara në shkelje. 3. Numrin e subjekteve që kanë ushtruar aktivitet pa licencë ose jashtë kushteve të lejuara.	04.06.2026	Përsëndetje, Bashkëlidhur po ju dërgojmë përgjigjen e kërkesës suaj. Faleminderit.	E plot	Nuk ka

		4. Numrin e gjobave dhe masave administrative të vendosura. 5. Nëse janë pezulluar aktivitete në zonën e lumit Mat. 6. Nëse janë referuar raste për ndjekje penale pranë organeve kompetente. Kjo kërkesë bazohet në ligjin e sipërpërmendur, i cili shprehet: “Kërkuesit i vihet në dispozicion një kopje e plotë e dokumentit zyrtar, për të cilin kërkon të informohet.” Duke u bazuar në ligjin nr 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit” i ndryshuar, këto informacione vihen në dispozicion të publikut pa kërkesë specifike dhe të arsyetuar”. Për çdo komunikim tjetër me qëllim orientimin dhe sqarimin e paqartësive, mund të më kontaktoni edhe në kontaktet e mëposhtme.				
57	22.05.2026	Përsëndetje Jam një banor i fshatit Kutë, Mallakastër i Qarkut Fier dhe Dua të raportoj një dëmtim të terrenit natyror të Parkut Kombëtar të Vjosës në fshatin Kutë të Mallakastrës. Dëmtimi po shkaktohet nga firma			Ne proces	

		SALILLARI që po kryen punime për mbrojtjen e tokave bujqësore nga lumi Vjosë në fshatin Çorrush , Mallakastër. Ata për të ulur shpenzimet e kompanisë,në vënd që të shkojnë të blejnë inertet e tyre atje ku shiten inerte me autorizim nga shteti, kanë filluar të shkatërrojnë terrenin për rreth duke dëmtuar rrugët rurale të fshatit Kutë dhe duke dëmtuar natyrën dhe habitatin e kafshëve dhe shpendëve lokal.				
58	22.05.2026	Pershendetje Bazuar ne ligjin per te drejten e informimit, kerkon nga Inspektoriati Kombetar i Mbrojtjes se Territorit, interviste, informacion ose dokumente per nje subjekt ne zonen e Ksamilit, Redi Aliaj. 1. Ne daten 19 maj 2026, Agjencia Kombetare e Bregdetit ju ka sjelle nje informacion per nje subjekt ne Ksamil, parcela SR 93, ne emer te z. REDI ALIAJ, person fizik, i cili po shfrytezon nje siperfaqe plazhi, duke ndertuar disa struktura guri, druri dhe metalike. AKB shkruan se jane konstatuar disa ndertime ...	04.06.2026	Përshëndetje, Bashkëlidhur gjeni përgjigjen ndaj kërkesës suaj. Faleminderit.	E plote	Nuk ka

		2. Nga vezhgimi i Fiks Fare, ne zone jane kryer disa punime sistemimi, vendosje guresh, konstruksione druri dhe metalike. A ka kryer ndonje kontroll IKMT ne ate subjekt? Nese po, cfare eshte konstatuar? 3. A lejohen ndertime ne ate prone, duke qene se e gjithe ajo siperfaqe eshte bllokuar nga Gjykata e Sarandes? Faleminderit				
59	25.05.2026	1. Sa ndertime pa leje jane evidentuar qe prej nisjes se aksionit, Korrik-Gusht te vitit te kaluar e deri me tani ne te gjithe Shqipërinë. Kryesisht ne cilat zona? Sa prej tyre ne Tirane? Sa kane qene objekte te larta te tilla si pallate, e sa te tjera biznese? Sa metra katror ndertim pa leje eshte evidentuar? 2. Sa persona jane arrestuar, proceduar per keto vepra penale?			Ne proces	

		3. Ne cilën zonë, apo qytete ka qene situata me problematike sa i perket ndertimeve pa leje? 4. Cili ka qenë rangu i të arrestuarve/ proceduarve nga ish-drejtori i imt dures, e deri tek persona te tjere?				
60	21.05.2026	Në cilësinë e trashëgimtarëve të një prone për të cilën jemi aktualisht në proces gjyqësor për njohjen dhe kthimin e pronës, dëshirojmë të kërkojmë verifikim lidhur me punime ndërtimi që po kryhen në zonën Vilu, Baks-Rrjollë. Gjate verifikimeve te bera ne vend kemi konstatuar se për të disatën here në këtë zonë po kryhen punime ndërtimi.	03.06.2026	Përhëndetje, Në vijim të kërkesës për informacion të ardhur në datë 21.05.2026 ju bëjmë me dije se nga verifikimet e kryera në terren nga Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit, Bashkia Shkodër, janë konstatuar punime ndërtimore padokumentacion teknik ligjor në zonën administrative Velipojë, njësia Baks-Rjollë. Për këtë rast është mbajtur Procesverbali për Konstatimin e Kundërvajtjes nr. 27, datë 12.05.2026, Vendimi Nr 1759 datë 12.05.2026 Për Pezullimin e Punimeve si dhe është marrë Vendimi nr. 1288, datë 21.05.2026, “Për prishjen e objektit të kundërligjshëm”.	E plote	Nuk

				Objekti i konstatuar përbëhet nga elementë beton armeje dhe punime ndërtimore të kryera pa leje ndërtimi, në kundërshtim me parashikimet e Ligjit nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar. Faleminderit.		
61	27.05.2026	Përsëndetje, Tiranë më, 27 Maj 2026 Pas disa ankesave nga qytetarë të zonës së Arapajt të Durrësit, pak metra pasi kalon vendin e quajtur "Pema e Jetës", operon një biznes "Wonderful Camping", në mes të rezervuarit të Durrësit dhe atij të Arapajt. Pavarësisht se ajo është tokë private, kemi konstatuar aktivitet të hedhjes së paligjshme të dherave, inerteve dhe mbetjeve të ngurta, të cilat në këtë rast shërbejnë për sheshimin e tokës private. Bashkëlidhur gjeni edhe pamjet shqetësuese, ku shihen kamiona të kompanive private që shkarkojnë në tokë bujqësore. Duke u mbështetur në Ligjin Nr. 119/2014 "Për të Drejtën e	03.06.2026	Përsëndetje, Bashkëlidhur po ju dërgojmë kthim-përgjigjen lidhur me kërkesën tuaj për informacion. Faleminderit.	E plote	Nuk ka

		Informimit," dhe në përputhje me nenet e këtij ligji, i cili rregullon të drejtën e njohjes me informacionin që prodhohet ose mbahet nga autoritetet publike, ju drejtohem me këtë kërkesë për të marrë informacionin e mëposhtëm: A ka ky operator privat leje të posaçme për hedhjen e këtyre materialeve në këtë zonë? Ku e marrin dheun, çakullin dhe granitin këta kamionë dhe që më pas e shkarkojnë në këtë hapësirë? A përbën ky aktivitet shkelje ligjore dhe a keni bërë kontrolle, pasi subjektet e caktuara duhet të pajisen me lejen përkatëse për kryerjen e këtij aktiviteti, qoftë operatori që hedh dhera, qoftë ai që i mbledh? Në rast të një kontrolli në vazhdimësi nga institucioni juaj, ju lutemi të na vendosni në dispozicion konstatimet/gjetjet lidhur me këtë ndotje mjedisore. Bazuar në detyrimet ligjore për transparencë dhe në të drejtën e qytetarëve për t'u informuar,				
--	--	--	--	--	--	--

		presim që të na mundësoni informacionin e kërkuar brenda afatit të përcaktuar nga legjislacioni në fuqi. Duke ju falënderuar paraprakisht për bashkëpunimin, mbetemi në pritje të një përgjigjeje sa më të shpejtë nga ana Juaj.				
62	21.05.2026	Në cilësinë e trashëgimtarëve të një prone për të cilën jemi aktualisht në proces gjyqësor për njohjen dhe kthimin e pronës, dëshirojmë të kërkojmë verifikim lidhur me punime ndërtimi që po kryhen në zonën Vilu, Baks-Rrjollë. Gjate verifikimeve te bera ne vend kemi konstatuar se për të disatën here në këtë zonë po kryhen punime ndërtimi.	03.06.2026	Përhëndetje, Në vijim të kërkesës për informacion të ardhur në datë 21.05.2026 ju bëjmë me dije se nga verifikimet e kryera në terren nga Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit, Bashkia Shkodër, janë konstatuar punime ndërtimore padokumentacion teknik ligjor në zonën administrative Velipojë, njësia Baks-Rjollë. Për këtë rast është mbajtur Procesverbali për Konstatimin e Kundërvajtjes nr. 27, datë 12.05.2026, Vendimi Nr 1759 datë 12.05.2026 Për Pezullimin e Punimeve si dhe është marrë Vendimi nr. 1288, datë 21.05.2026, “Për prishjen e objektit të kundërligjshëm”. Objekti i konstatuar përbëhet nga elementë beton armeje dhe punime	E plote	Nuk ka

				ndërtimore të kryera pa leje ndërtimi, në kundërshtim me parashikimet e Ligjit nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar. Faleminderit		
63	21.05.2026	Pershendetje, ju bej me die se ne Himare eshte shkaterruar ponen publike, burimin e unit qindra vjecar, duke pervetesuar hapesiren anash burimit e duke e bere pjese t elokatit. Vjet tento me beton por e ndalun Dhe e mbuloi vetem me dru, kete vit, sic e shihni ka hedhur beton. Nder te tjera ky hotel flitted qe eshte I palegalizuar por ne kundërshtim nga vjet qe ishte Plazh publik, kete vit i eshte dhene si Plazh privat. Glatte punimeve ne prill, ka hedhur beton ne gurat e plazhit. Ju ftoj te merci masa menjehere. Faleminderit	08.06.2026	Përsëndetje, Bazuar në ankesën tuaj ju bëjmë me dije se: Në zbatim të Akt-Marrëveshjes Nr. 202, datë 19.02.2026, janë kryer punime për pastrimin dhe përforcimin e kanalit në zonën e Potamit, si pasojë e rrëshqitjeve të dherave dhe bllokimit të tij nga prurjet. Ndërhyrja është realizuar për të garantuar funksionimin normal të kanalit dhe për të shmangur rrezikun e përmbytjeve. Bashkëlidhur shkresa nga Ndërmarrja e Shërbimeve Publike. Faleminderit.	E plote	Nuk ka

64	24.05.2026	Nëpërmjet këtij kallëzimi penal anonim parashtrohen dyshime të arsyeshme se subjekti “Kamping Mulliri i Benjës”, që ushtron aktivitet në një zonë të mbrojtur natyrore/pranë territorit të Parkut Kombëtar, ka kryer dhe vijon të kryejë veprime të kundërligjshme të përsëritura, të cilat mund të sjellin pasoja të rënda për mjedisin, shëndetin publik dhe rendin juridik. KONSTATIME KRYESORE Përdorim dhe zaptim i hapësirës publike/shtetërore për parkim kundrejt pagesës, pa autorizim apo bazë të dukshme ligjore; Moslëshim i kuponit tatimor ndaj klientëve dhe dyshim i arsyeshëm për shmangie të detyrimeve fiskale; Shkarkim i ujërave të zeza direkt në lumë, pa sistem të ligjshëm trajtimi apo filtrimi, duke shkaktuar ndotje mjedisore; Ndërhyrje të paautorizuara në shtratin e lumit, përfshirë hapjen e pusit apo devijime të mundshme të burimeve ujore pa leje përkatëse; Kryerje ndërtimesh pa leje ose në kundërshtim me legjislacionin	25.06.2026	Përhëndetje, Bashkëlidhur gjeni përgjigjen ndaj kërkesës suaj. Faleminderit.	E plote	Nuk ka
----	------------	---	------------	--	---------	--------

		urbanistik dhe mjedisor brenda apo pranë zonës së mbrojtur. KUALIFIKIM I MUNDSHËM JURIDIK (PA PARAGJYKIM) Veprimet e sipërpërmendura mund të përbëjnë elementë të veprave penale dhe/ose shkeljeve administrative sipas legjislacionit shqiptar në fuqi, përfshirë: ndotjen e ajrit, ujit dhe tokës; ndërtimin e paligjshëm; dëmtimin dhe cenimin e zonave të mbrojtura; shkeljet në administrimin e burimeve ujore; fshehjen e të ardhurave dhe shmangien e detyrimeve tatimore. KËRKESË Kërkohet nga organet kompetente: regjistrimi i këtij kallëzimi dhe nisja e verifikimeve paraprake; kryerja e inspektimit në terren dhe dokumentimi i situatës faktike; verifikimi dhe sekuestrimi, kur është e nevojshme, i dokumentacionit administrativ, fiskal dhe teknik të aktivitetit;				
--	--	---	--	--	--	--

		kryerja e ekspertimit mjedisor për vlerësimin e ndotjes së lumit dhe ndikimit në zonën e mbrojtur; verifikimi i përgjegjësiive individuale dhe institucionale; marrja e masave të menjëhershme ligjore për pezullimin e çdo aktiviteti të kundërligjshëm. Ky kallëzim paraqitet në mënyrë anonime në mbrojtje të interesit publik, mjedisit, pasurive natyrore dhe zbatimit të ligjit.				
65	25.05.2026	Drejtohem pranë jush për të paraqitur një ankesë zyrtare në lidhje me një ndërtim të paligjshëm që ka bllokuar plotësisht rrugën hyrëse të pronës sime.	26.05.2026	Përsëndetje , Drejtuar: Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit, Bashkisë Lushnjë Në dijeni: Në adresën e-mailit të koordinаторit të të drejtës për informim, IKMT, është paraqitur kërkesa nga Z.. Bashkëlidhur po ju përcjellim kërkesën dhe lutemi në trajtimin e saj brenda afateve të cituara nga ligji. Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,	E plote	Nuk ka

66	27.05.2026	Përschendetje, Bashkëlidhur do të gjeni kërkesën për informacion dhe linkun: https://we.tl/t-SBsHS05ueapkNJUA Në pritje të një përgjigjeje sa më të shpejtë nga ana juaj, Faleminderit për bashkëpunimin.	03.06.2026	Përschendetje, Bashkëlidhur po ju dërgojmë kthim-përgjigjen lidhur me kërkesën tuaj për informacion. Faleminderit.	E plote	Nuk ka
67	31.05.2026	Pershendetje Une jam banore i njesise nr.2 tek Rruga Pandeli Evengjeli, ngjitur me shtepine time ushtron aktiviteti Mobileri Kolaveri me admistrator Xhevahir Kolaverin. Problem qe ka gjithe lagja ku banojme eshte aktiviteti qe ai ushtron ngjitur me shtepite tona si mobileri kryen Zhurmat e mobileri, era e bojrave, shkarkimet e ndryshme,bllokim e rruges me mjetet e renda,bllokim aksesit perpara banesave tona. Kryen aktivitet Lavazhi shpesh here te makinave te punes. Parkimet e ndryshme me mjetet e renda, ne vitin 2009 ka bllokuar 1 rruge aksesimin qe perdorej per dalje te makinave dhe	19.06.2026	Përschendetje, Bashkëlidhur po ju dërgojmë përgjigjen e ardhur nga AKM. Faleminderit.	E plote	Nuk ka

		kembesoreve perballe Sofra Te Ariut Rruga e Elbasanit.				
68	05.06.2026	Përschendetje, Po ju drejtohem në cilësinë e një qytetareje dhe profesionisteje të fushës së arkitekturës, me një kërkesë për verifikim dhe mbikëqyrje institucionale lidhur me zbatimin e procedurave për kontrollin e territorit nga ana e IMT Lushnje. Nga dokumentacioni zyrtar që disponoj rezulton se: IMT Lushnje ka konstatuar kryerjen e punimeve pa leje ndërtimi; është mbajtur procesverbali përkatës i konstatimit të kundërvajtjes; është vendosur masa administrative me gjobë; me Vendimin Nr. 187, datë 20.01.2026 është urdhëruar	08.06.2026	Përschendetje, Në lidhje me ankesën tuaj për egzekutimin e vendimit për prishje objekti me Nr. 187, datë 20.01.2026 , në zbatim të ligjit Nr.9780 datë 16.07.2007 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme” i ndryshuar, perkatesisht neni 4 i këtij ligji, "Për përmbushjen e përgjegjësisë të parashikuara me ligj, inspektorati i mbrojtjes së territorit i njësisë vendore mbështetet nga policia e njësisë vendore dhe pajiset me mjetet dhe makineritë e nevojshme nga njësia vendore”, dhe ka detyrim ligjor zbatimin e drejtë dhe korrekt të tij për zgjedhjen e problematikave dhe ekzekutimin e vendimeve të marra brenda territorit që ka nën juridiksion. Duke ju falenderuar për bashkëpunimin!	E plote	Nuk ka

		prishja e objektit të kundërligjshëm; me shkresën Nr. 3763 Prot., datë 21.04.2026, subjekti është njoftuar për kryerjen e prishjes vullnetare brenda 10 ditëve. Pavarësisht këtyre veprimeve administrative, objekti vazhdon të ekzistojë në terren edhe sot, disa muaj pas nxjerrjes së vendimit për prishje. Gjatë komunikimeve të zhvilluara me IMTV Lushnje kam marrë përgjigje sipas të cilave ekzekutimi i vendimit do të kryhet pasi të sigurohen mjetet dhe burimet njerëzore të nevojshme, por pa u përcaktuar një afat konkret dhe pa u bërë i ditur ndonjë plan veprimi për ekzekutimin e vendimit. Gjithashtu, në vijim të një ankese të paraqitur pranë Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, jam informuar se çështja në fjalë duhet të trajtohet në kuadër të ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007 "Për inspektimin e ndërtimit", ligjit nr. 107/2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit" si dhe VKM nr. 894, datë 04.11.2015 "Për unifikimin e				
--	--	---	--	--	--	--

		procedurave të kontrollit të territorit nga Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit dhe ai i njësisë vendore". Theksoj gjithashtu se objekti i kundërligjshëm është ndërtuar në afërsi të menjëhershme të pronës fqinje, duke krijuar ndikim të drejtpërdrejtë në përdorimin normal të saj. Për shkak të pozicionimit dhe lartësisë së strukturës, janë krijuar shqetësime të arsyeshme që lidhen me privatësinë dhe sigurinë e pronës ngjitur, gjë që e bën edhe më të rëndësishëm zbatimin në kohë të vendimit administrativ të prishjes. Në këto kushte, kërkoj nga ana juaj: Verifikimin e procedurave të ndjekura nga IMT Lushnje në lidhje me ekzekutimin e Vendimit Nr. 187, datë 20.01.2026; Verifikimin e arsyeve të moszbatimit të këtij vendimi deri në këtë moment; Vlerësimin nëse procedurat e parashikuara nga legjislacioni në fuqi dhe VKM nr. 894, datë 04.11.2015 janë respektuar plotësisht;				
--	--	--	--	--	--	--

		Ushtrimin e kompetencave mbikëqyrëse që ju njih ligji në rast se konstatohen vonesa ose mosveprime administrative. Bashkëlidhur po përcjell dokumentacionin përkatës administrativ, përfshirë vendimin për prishje, njoftimin për prishje vullnetare, komunikimet e zhvilluara me IMT Lushnje dhe përgjigjen e Komisionerit. Kjo kërkesë paraqitet me synimin për të siguruar zbatimin e vendimeve administrative dhe respektimin e legjislacionit për kontrollin e territorit. Faleminderit për bashkëpunimin.				
69	18.06.2026	Përsëndetje, Kam një gjobë të vendosur nga IKMT në vitin 2021, me vlerë fillestare 500,000 lekë (5 milionë lekë të vjetra), për biznesin tim , i cili ndodhet në Bulqizë . Gjopa nuk është paguar dhe aktualisht ndodhet në procedurë përmbaremore. Duke iu referuar ligjit/vendimit të fundit për faljen e gjobave administrative, ju lutem të verifikoni nëse rasti im përfiton	25.06.2026	Përsëndetje, Bashkëlidhur po ju dërgoj përgjigjen e kërkesës suaj. Faleminderit!	E plote	Nuk ka

		nga falja dhe të më informoni mbi procedurën që duhet të ndjek. Nëse nevojiten të dhëna shtesë (numri i vendimit, NIPT-i, etj.), jam i gatshëm t'i vë në dispozicion. Faleminderit për bashkëpunimin. Ne pritje te përgjigjes tuaj.				
70	18.06.2026	Keto hapësira publike (plazh publik) e percaktuar nga agjensia kombetare e bregdetit janë zaptuar dhe kanë privuar qytetaret të shfrytëzojnë hapësirat publike të drejte që ja ka percaktuar ligji. Për këtë kemi njoftuar direkt dhe drejtorin e përgjithshëm. Ju lutemi merni masa për lirim të tyre zona është tek shetitorja golem pranë perroit të agait. Hapësirat publike janë të percaktuara në hartat e a.k.b si parcela publike.	25.06.2026	Përsëritet, Në lidhje me ankesën tuaj për lirim të hapësirave publike, ju bëjmë me dije se për objektin “Park Lojërash” është marrë vendim për masë administrative me gjobë, si dhe vendim për prishjen e objektit të kundërligjshëm. Ndërsa për objektin “Rio Beach Bar”, ju informojmë se subjekti është pajisur me dokumentacionin përkatës, në përputhje me legjislacionin në fuqi për strukturat në shërbim të plazheve. Faleminderit për mirëkuptimin.	E plotë	Nuk ka

71	26.06.2026	Banorët e kësaj zone ne spitall tek nenstacioni elektrik po përballen çdo ditë me një shqetësim të madh nga lëvizja e kamionëve të një kompanie kromi, të cilët kalojnë pranë dyerve të shtëpive tona pa orar, pa rregull dhe pa asnjë kujdes për jetën e banorëve. Kamionët kalojnë me shpejtësi të lartë, aq sa na tronditen shtëpitë. Pluhuri është bërë i padurueshëm, nuk mbajmë dot dritaret hapur, nuk dalim dot lirisht te dera e shtëpisë dhe fëmijët e të moshuarit janë të detyruar të jetojnë mes zhurmës, frikës dhe ndotjes. Njerëzit nuk bëjnë më gjumë normal. Nuk ka më qetësi, nuk ka më ajër të pastër, nuk ka më siguri. Nuk mund të jetojmë me kamionë që kalojnë orar pa orar, ditë e natë, sikur kjo zonë të mos ketë banorë, familje dhe fëmijë. Kjo nuk është thjesht bezdi. Ky është problem serioz për shëndetin, sigurinë dhe jetën e përditshme të banorëve. I bëjmë thirrje Bashkisë Durrës, Policisë Rrugore, Inspektoratit të Mjedisit dhe çdo institucioni	30.06.2026	Faleminderit, Në lidhje me këtë situatë sqarojmë se: Rregullimi dhe administrimi i qarkullimit rrugor, përfshirë kontrollin e mjeteve dhe respektimin e rregullave të qarkullimit, është kompetencë e Policisë së Shtetit, në zbatim të Ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit” dhe Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë. Administrimi i rrugëve vendore dhe ndërhyrjet për rehabilitimin apo devijimin e qarkullimit të mjeteve janë kompetencë e Bashkisë, në përputhje me Ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”. Për këtë arsye ju lutem ti drejtoheni institucioneve kompetente për ankesën tuaj. Faleminderit.	E plote	Nuk ka
----	------------	--	------------	--	---------	--------

		përgjegjës të vijë urgjentisht në terren, të verifikojë situatën dhe të marrë masa konkrete. Ne nuk jemi kundër punës së askujt, por puna e askujt nuk mund të bëhet mbi gjumin, shëndetin dhe sigurinë e banorëve.				
72	29.06.2026	Unë Besmir Pula, gazetar i MCN TV, në bazë të ligjit Nr. 119/2014 për të drejtën e informimit dëshiroj të njihem me disa informacione në lidhje me ... 1. Lidhur me pretendimet e banorëve të fshatit Pëllumbas në Tiranë, se guroret në këtë zonë bashkë me mjetet e tonazhit të rëndë shkaktojnë ndotje masive mjedisore, shqetësim për to, për zhurmat etj... kërkojmë informacionin e mëposhtëm. 2. Si qëndron e verteta, çfarë aktivitete kryejnë këto gurore, çfare	06.07.2026	Përsëndetje, Bashkëlidhur po ju dërgojmë përgjigjen lidhur me kërkesën tuaj. Faleminderit.	E plote	Nuk ka

		lelesh mjedisore përkatëse disponojnë? Ju lutem na vini në dispozicion të gjithë të dhënat e mundshme të aktivitetit dhe lejeve, për transparencë dhe bazuar në interesin publik pas ankesave të vetë banorëve të zonës, të cilët shprehin shqetësimin e tyre për mikrofonin e MCN Tv? 3. Cilët janë kompanitë që kanë biznese gurore në këtë zonë, për aq kohë sa nuk ka asnjë tabelë orientuese në hyrje të biznesit për aktivitetin apo kompaninë. Për transparencë kërkojmë informacion në lidhje me aktivitetin dhe listën e kompanive që shfrytëzojnë këtë zonë kryesisht malin pas fshatit Pëllumbas?				
--	--	--	--	--	--	--

73	02.07.2026	Jam nje banor I lagjes 13 Plazh Durrës. Dua te bej nje ankese per zaptim te hapësires se perbashket. Vendodhja: Pallati Arabit pas fast foodit "Chicken House ,, prane shkolles Bajram Curri. Direkt nga pjesa mbrapa fast foodit ndodhet nje dyqan Peshku. Me pare aty ka qene si tynel, hapësire e perbashket per banoret e pallatit per te kaluar ne pjesen e perparme te pallatit. Ky zoteria qe sot e ka kthy ne dyqan e zaptoi duke vendosur nje qepen dhe e ktheu ne biznes, dhe nuk eshte fare banor aty. Ju lutem merrni masa.	07.07.2026	Përshëndetje , Drejtuar: Inspektoriati i Mbrojtjes së Territorit, Bashkisë Durrës Për dijeni Në adresën e-mailit të koordinitorit të të drejtës për informim, IKMT, është paraqitur kërkesa/ankesa. Bashkëlidhur po Ju përcjellim për kompetencë kërkesën e paraqitur nga Z. Beruze Papa për verifikim dhe trajtim nga ana Juaj. Faleminderit!	E plote	Nuk ka
74	07.07.2026	Bashkëngjitur këtij email-i kam paraqitur kërkesën për informacion për të cilën jemi të interesuar të kemi informacion. Duke iu falenderuar paraprakisht, në pritje të përgjigjes tuaj!	07.07.2026	Përshëndetje, Bashkëlidhur po ju dërgojmë kthim-përgjigjen lidhur me kërkesën tuaj për informacion. Faleminderit.	E plote	Nuk ka

75	17.07.2026	Të nderuar Zonja/Zotërinj të IKMT-së, Ju drejtohem me këtë paralajmërim përfundimtar në lidhje me ndërtimin e paligjshëm që po kryhet në pronën tonë private në fshatin Rrjoll, Velipojë, Shkodër.	21.07.2026	Përsëndetje, Bashkëlidhur po ju dërgojmë kthim-përgjigjen lidhur me kërkesën tuaj për informacion. Faleminderit.	E plote	Nuk ka
76	22.07.2026	Përsëndetje, Bashkëlidhur do të gjeni kërkesën për informacion dhe shkresat referuese. Në pritje të një përgjigjeje sa më të shpejtë nga ana juaj, Faleminderit për bashkëpunimin.	24.07.2026	Përsëndetje, Bashkëlidhur po ju dërgojmë kthim-përgjigjen lidhur me kërkesën tuaj për informacion. Faleminderit.	E plote	Nuk ka

Shënim:

¹ Numri rendor i kërkesave të regjistruara në Regjistrin e Kërkesave dhe Përgjigjeve

² Data e regjistrimit të kërkesave

³ Përmbledhje e objektit të kërkesës duke u anonimizuar sipas parashikimeve ligjore në fuqi

⁴ Data e kthimit të përgjigjes

⁵ Përmbajtja e përgjigjes duke u anonimizuar sipas parashikimeve ligjore në fuqi

⁶ Përgjigja jepet E plotë/E kufizuar/E refuzuar/E deleguar

⁷ Kosto monetare e riprodhimit (kur është rasti dhe e dërgimit) të informacionit të kërkuar sipas tarifave të publikuara nga autoriteti publik.